

Manual mbi historinë gojore

Ide dhe praktika për nxënës,
mësues dhe studiues të rinj



INSTITUTI PËR DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURË

MANUAL MBI HISTORINË GOJORE

IDE E PRAKTIKA PËR NXËNËS, MËSUES
DHE STUDIUES TË RINJ

MANUAL PËR HISTORINË GOJORE

Ide dhe praktika për nxënës, mësues dhe studiues të rinj

Një botim i Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC)
(Institute for Democracy, Media and Culture)

Adresa: Rr. Bardhok Biba
Hyrja A, Kati 11, Tiranë
Tel: +355 44521899
Email: office@idmc.al
www.idmc.al

Projekti është mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer (KAS) në Tiranë

Adresa: Blv. Dëshmorët e Kombit
Kullat Binjake 1, Kati 11, Zyra A3
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 22 66 525
Email: info.tirana@kas.de

Copyright © Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC)
(Institute for Democracy, Media and Culture)

Botimi i parë FILARA
Tiranë, 2018

ISBN 978-9928-4482-1-7

Shtypur në shtypshkronjën FILARA
Adresa: Rr. "Sabaudin Gabrani",
ish-Kombinati "Misto Mame" Tiranë
Tel: 042258801
Email: filarabotime@yahoo.com

PARATHËNIE

Gjatë organizimit të përvitshëm të konkursit "Pyet gjyshërit" më ka rënë në sy dëshira e të rinjve për të intervistuar pjesëtarë të familjes apo për të mbledhur histori në komunitetin ku jetojnë. Përmes historive jetësore, siç shprehen edhe vetë, ata kanë zbuluar tema dhe çështje që ndikojnë në një farë mënyre edhe jetën e tyre sot. Mbledhja e dëshmive gojore nuk është një instrument që përdoret në shkollat tona. Për këtë arsye, Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) është përpjekur prej vitesh ta inkurajojë këtë jo vetëm me konkurset për të rinj. Në kuadër të projektit "Unë dëshmoj", me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer (KAS), janë kryer prej disa vjetësh intervista me persona, dëshmitë e të cilëve hedhin dritë mbi përndjekjen gjatë regjimit komunist shqiptar, në vitet 1944-1990. Këto dëshmi mund të aksesohen nga kushdo në faqen online të Observatorit të Kujtesës (observatorikujteses.al).


Procesi i dokumentimit dhe arkivimit të këtyre dëshmive ndër vite, por edhe problemet që hasëm gjatë kësaj pune, na frymëzoi të punonim për të sjellë në jetë një Manual, për të inkurajuar të rinjtë, gjimnazistët, të mbledhin sa më shumë histori gojore. Por materialet e Manualit mund të përdoren nga grupe të ndryshme interesi: mësues të historisë dhe lëndëve të tjera relevante, studentë, historianë, gazetarë, studiues dhe të interesuar të tjerë. Synimi ynë si IDMC është të sensibilizojmë mbi rëndësinë e mbledhjes së historive gojore për ndriçimin e historisë. Përdorimi i historive gojore nga mësuesit dhe nxënësit ndihmon në aktualizimin e historisë, të përballjes me nocionet e demokracisë dhe diktaturës, si dhe me ruajtjen e një kujtese kolektive të përbashkët.

Në punën tonë për mbledhjen e dëshmime gojore kemi parë shumë qartë se mbledhja e dëshmime gojore është një proces që shkon përtej vendosjes së një mikrofoni apo regjistruesi në mes të tavolinës dhe inkurajimit të familjarëve për të treguar jetën e tyre. Sepse dokumentimi i perspektivave të ndryshme të mënyrës si e kupton gjithsecili të shkuarën është një vlerë e shtuar për kujtesën tonë kolektive. Manuali është i pajisur me kapituj që do t'i shpjegojnë nga afër problematikat e këtij procesi si dhe mekanizmat për të mbledhur dëshmitë gojore.


Ky Manual do të ishte i pamundur pa punën e palodhshme të disa njerëzve që na kanë shoqëruar gjatë muajve që përpilohej Manuali: Valbona Bezati që ndau me ne përvojën e intervistimit dhe editimit të historive gojore në kuadër të Observatorit të Kujtesës; Matilda Karçanaj për koordinimin e kapitujve dhe rishikimin e punimit final; Vojsava Kumbulla dhe Gentian Dedja për kritikën e tyre të vlefshme nga këndvështrimi i mësuesve që do ta aplikojnë atë në orët e mësimit; Sonila Danaj dhe Idris Idrizi për redaktimin shkencor të Manualit nga perspektiva e studiesve të rinj; si dhe Ana Pekmezi për faqosjen profesionale.

Dr. Jonila Godole
Drejtore e IDMC

AUTORËT



Dr. Jonila Godole është prej vitit 2005 pedagoge në Universitetin e Tiranës, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit. Ajo ka studiuar për shkencë politike, sociologji dhe pedagogji në Universitetin "Johann Wolfgang Goethe" Frankfurt am Main. Godole ka qenë një nga gazetaret e para të shtypit të pavarur në Shqipëri pas rënies së regjimit komunist, e njohur sidomos për intervistat politike. Është doktore e shkencave që prej vitit 2013 dhe autore e dhjetëra artikujve shkencorë botuar brenda dhe jashtë vendit kushtuar zhvillimit të mediave dhe gazetarisë në vendet postkomuniste. Prej vitit 2014 Godole është drejtore ekzekutive e IDMC (www.idmc.al), një institucion partner i Fondacionit Konrad-Adenauer në Tiranë.



Kailey Rocker është kandidate për doktoraturë në Departamentin e Antropologjisë në Universitetin e Karolinës së Veriut, Chapel Hill (UNC). Ajo ka një master në Antropologjinë Kulturore nga UNC dhe Bachelor në Sociologji dhe Antropologji nga Kolegji Millsaps në Xhakson, Misissipi. Projekti i saj i tanishëm i kërkimit ndjek rritjen e kohëve të fundit të projekteve të kujtesës historike të periudhës socialiste në Shqipëri dhe fokusohet në veçanti në angazhimin e të rinjve.



Edlira Agolli ka diplomë Master për Studime Evropiane dhe diplomë universitare në Letërsi. Në vitet 2003-2006 ka punuar si arkiviste në Prezencën e OSBE-së në Shqipëri. Që prej vitit 2015, po në këtë institucion koordinon projektin "Mbështetja e një platforme kombëtare për trajtimin e të kaluarës komuniste në Shqipëri."

LISTA E SHKURTESAVE

AHA	American Historical Association (Shoqata e Historisë Amerikane)
AOH	Association for Oral History (Shoqata për Historinë Gojore)
CCOHR	The Columbia Center for Oral History Research (Qendra e Columbusë për Studimin e Historisë Gojore)
IDMC	Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë
IIPP	Instituti Ish të Përndjekurit Politikë
ISKK	Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit
OHA	Oral History Association (Shoqata e Historisë Gojore)
OHS	Oral History Society (Shoqëri e Historisë Gojore)
OSCE	Organization for the Security and Cooperation in Europe (Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë)
SOHP	The Southern Oral History Program (Programi i Historisë Gojore nga Jugu)

PASQYRA E LËNDËS

Parathënie	03
Lista e shkurtesave	06

HYRJE

TË DHËNA PËR PËRDORIMIN E MANUALIT

Kujt i drejtohet ky manual?	09
Cilat janë objektivat kryesore të këtij manuali?	09
Çfarë përfshin ky manual?	10
Shënim mbi terminologjinë	12

KAPITULLI 1

NJË VËSHTRIM HISTORIK I HISTORISË GOJORE	13
Çfarë është intervista e historisë gojore dhe si u zhvillua kjo metodologji?	13

KAPITULLI 2

NJË SHËNIM PËR ETIKËN PARA SE TË FILLONI

TË PËRDORNI HISTORINË GOJORE	17
Etika e kryerjes, përdorimit, ruajtjes, publikimit dhe shpërndarjes së historive gojore	18
“Mbi mbrojtjen e të dhënave” në Shqipëri	19

KAPITULLI 3

PROCESI I INTERVISTIMIT NË HISTORINË GOJORE	22
Hapi i parë - Faza përgatitore (gjetja e temës dhe e dëshmitarit)	23
Hapi i dytë - Intervistimi	26
Hapi i tretë - Analiza e intervistës dhe prezantimi i rezultateve	30
Hapi i katërt - Marrëveshja e mirëkuptimit mes palëve dhe e drejta e autorit ..	32

KAPITULLI 4

ZHVILLIMI I NJË PROJEKTI BAZUAR NË HISTORINË GOJORE	35
Planifikimi tematik dhe shkrimi i projektit me bazë historinë gojore	35
Dokumente ndihmëse	41

KAPITULLI 5**RUAJTJA DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE TË MBLEDHURA**

NGA HISTORIA GOJORE	45
Arkivimi i regjistrimeve	46
Dixhitalizimi i arkivës së historisë gojore	49
Publikimi i historisë gojore në forma të ndryshme dhe vlera e saj	50

KAPITULLI 6**MËNYRAT PËR TË PËRFSHIRË INTERVISTAT E HISTORISË**

GOJORE NË SHKOLLA DHE NË PUNË KËRKIMORE	55
Si të motivojmë nxënësit e shkollave të mesme që të zhvillojnë projekte me historinë gojore	57
Krijimi i njohurive të reja - përdorimi i historisë gojore në kërkimin tuaj	67

SHTOJCA A

BURIME TË TJERA PËR HISTORINË GOJORE NGA INTERNETI	71
---	-----------

SHTOJCA B

MATERIALET PËR TË REALIZUAR NJË PROJEKT TË HISTORISË GOJORE	77
--	-----------

Fjalorthi i termave të përdorura në manual	82
---	-----------

Bibliografia	89
---------------------------	-----------

HYRJE**TË DHËNA PËR PËRDORIMIN E MANUALIT****Kujt i drejtohet ky manual?**

A ju ka ndodhur të keni pyetur ndonjëherë një pjesëtar të familjes ose ndonjë të afërm që t'ju tregojë përvojën e tij personale lidhur me një ngjarje historike? A keni dëgjuar ndonjëherë për termat: histori gojore, intervistë e thelluar, histori e jetës, narrativë e jetës ose memoar i regjistruar? A keni menduar ndonjëherë për përfshirjen e intervistave të historisë gojore si mësim jashtëshkollor në klasën tuaj të shkollës së mesme ose si një metodë pune për projektin tuaj të kërkimit? A jeni mësues i shkollës së mesme apo studiues i ri? Nëse jeni përgjigjur “po” për ndonjë nga pyetjet e mësipërme, atëherë ky manual është për ju. Në këtë doracak, ne eksplorojmë potencialin që përmban intervista për të mbledhur dëshmi të historisë gojore, duke pasur parasysh mësuesit e shkollave të mesme dhe studiuesit e rinj. Ndërkohë, besojmë se mbledhja e historive gojore, e cila paraqet një perspektivë unike dhe personale mbi të kaluarën, është një metodologji që nuk është eksploruar shumë në shkollat e mesme shqiptare dhe në studimet universitare.

Cilat janë objektivat kryesore të këtij manuali?

Gjatë përgatitjes së këtij manuali, kemi pasur parasysh dy objektiva: (1) të inkurajojmë mësuesit e shkollave të mesme dhe studiuesit e rinj që të mësojnë më shumë rreth historisë gojore dhe procesit të intervistimit; (2) t'u paraqesim atyre mjetet e nevojshme për t'i përfshirë

këto intervista në detyrat dhe projektet kërkimore në shkollat e mesme. Për të arritur këto objektiva, materiali është organizuar në mënyrë të tillë, ku disa kapituj trajtojnë zhvillimin e historisë gojore dhe metodave të intervistimit, nga fillesat e saj dhe deri te përcaktimi bashkëkohor. Në kapitullin e parë paraqitet një përmbledhje e pesë kapitujve vijues si dhe informacione shtesë mbi etikën e zhvillimit dhe përdorimit të intervistave të historisë gojore.

Çfarë përfshin ky manual?

Kapitulli 1 trajton përhapjen e metodës së historisë gojore në mes të shekullit të 20-të dhe rritjen e rëndësisë së saj në ditët e stome, veçanërisht, në kërkimin shkencor të shkencave sociale. Dëshmitë e dëshmitarëve okularë mbi ngjarje nga e kaluara transformojnë në mënyrë të rëndësishme perceptimin tonë mbi historinë, duke e çliruar nga këndvështrimi i njëanshëm dhe duke e treguar atë nga disa perspektiva. Ky proces, jo vetëm ndryshon fokusin tonë personal, por mundëson edhe shtrirjen në grupime dhe përfshin persona, të cilët tradicionalisht, nuk kanë qenë të përfshirë në diskutimin e historiografisë dhe fushave të ngjashme me të. Gjithashtu, këto lloj intervistash na lejojnë që të kuptojmë se si janë perceptuar dhe përjetuar momentet historike dikur dhe si vazhdojnë të përjetohen ato në ditët e sotme.

Për shkak të përgjegjësisë tonë etike ndaj atyre që ndajnë me ne historitë dhe dëshmitë e tyre, në Kapitullin 2 do flasim për etikën e zhvillimit, përdorimit dhe publikimit të intervistave të historisë gojore. Kjo pjesë thekson se kushdo që është i interesuar të përdorë historinë gojore, përpara se ta përfshijë këtë metodë në detyrat e klasës apo në projekte kërkimore, duhet të ketë parasysh rregullat e etikës dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave dhe të të drejtave të autorit.

Kapitulli 3 paraqet një këndvështrim mbi mënyrën se si zhvillohen metodat e intervistimit të historisë gojore. Këtu tregohen katër hapa

kryesorë: (1) kërkimi mbi temën, identifikimi i personave që do të intervistohen dhe marrja e pëlqimit për pjesëmarrjen e tyre në intervistë; (2) zhvillimi i intervistës; (3) ndërmarrja e hapave të parë për të analizuar dhe paraqitur rezultatet. Hapi i fundit fokusohet mbi rëndësinë e ndërtimit të një raporti miqësor mes intervistuesit dhe të intervistuarve dhe respektimit të të drejtave të tyre si subjekte të intervistimit.

Kapitulli 4 paraqet strategjitë për të zhvilluar projekte për shkollat e mesme dhe për studime duke pasur në fokus historinë gojore. Përpara se të zhvillojnë intervista të historisë gojore, drejtuesit e projektit (mësuesit ose kërkuesit shkencorë) dhe stafi mbështetës (nxënës, studentë ose asistentë) duhet të identifikojnë një temë kryesore dhe tematikat e projektit të historisë gojore, si dhe objektivat kryesorë për projektin. Në këtë kapitull, mund të gjeni koncepte formash dhe sugjerime se si t'i përmbushim gjithë sa përmendëm më sipër.

Kapitulli 5 jep detaje mbi mënyrat se si mund të organizosh, ruash dhe prezantosh të dhënat e grumbulluara nga projektet e historisë gojore. Këtu mund të gjenden forma të nevojshme, të cilat drejtuesit dhe personeli mbështetës i projektit mund t'i përdorin për të arkivuar të gjithë materialet, nga propozimi fillestar i projektit. Gjithashtu, ky kapitull diskuton mbi rëndësinë e arkivit dixhital dhe përdorimin e tij në rritje, si një nga mënyrat më efikase për të ndarë të dhënat tuaja të historisë gojore me publikun.

Së fundmi, kapitulli 6 fokusohet në mënyrat e ndryshme, ku mësuesit dhe kërkuesit shkencorë mund të përdorin historinë gojore në shkolla apo në projekte kërkimore. Gjysma e parë u dedikohet mësuesve të shkollave të mesme dhe paraqet dy përqasje të ndryshme mbi përfshirjen e historisë gojore në praktikën mësimore. Pjesa tjetër e Kapitullit i drejtohet studiuesve të rinj dhe paraqet shembuj të ndryshëm se si ata kanë përdorur intervistën e historisë gojore.

Shënim mbi terminologjinë

Një term që ju do ta hasni rregullisht gjatë leximit të këtij manuali është “oral history”- histori gojore. Ky term i referohet njëherazi dëshmisë verbale mbi të kaluarën për ata që e kanë përjetuar, por është dhe një metodë shkencave të historisë për të mbledhur këto dëshmi. Në këtë manual kemi zgjedhur të përdorim në mënyrë strikte termin **“histori gojore”** në vend të ndonjë termi tjetër si “histori e rrëfyer”, për shembull, sepse është më afër strukturës së terminologjisë origjinale dhe, sepse është përdorur gjerësisht nga studiuesit shqiptarë brenda dhe jashtë vendit. Jemi të vetëdijshëm se termi “histori gojore” mund të krijojë fillimisht ndonjë pështjellim kuptimor, por shpresojmë se nga fundi i manualit, paqartësitë do të jenë zhdukur pas thellimit të njohurive në këtë fushë.

Në vazhdim, teksti është i pajisur me një numër termash që ne i kemi konsideruar të rëndësishme për historinë gojore dhe metodologjinë që përdoret në këtë Manual. Të gjithë këta terma janë organizuar nga ana alfabetike dhe janë vendosur në një fjalorth, i cili ndodhet në Shtojcën B dhe në bibliografi. Fjalorthin mund ta gjeni në faqen 82-88.

Kujtohuni të kontrolloni shtojcat për burime dhe informacione shtesë. Shtojca A përmban të dhëna për materiale shtesë që gjenden në internet, duke përfshirë edhe linqet në arkivat e historisë gojore. Shtojca B përfshin versione të paplotësuara të të gjitha formave të përfshira në këtë Manual, të cilat ju mund t'i përdorni për të zbatuar projektet tuaja me dëshmi të historisë gojore.


KAPITULLI 1

NJË VËSHTRIM HISTORIK I HISTORISË GOJORE

Ky kapitull ju prezanton fillimisht me origjinën e historisë gojore. Më pas vazhdon me përkufizimin e historisë gojore dhe përfundon me rëndësinë e saj si një vlerë e shtuar në studimin e historisë. Në këtë kapitull do të vëmë re se historia gojore si fushë studimi nuk është shumë e vjetër dhe se gjeneza e saj ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Përkufizimi i saj është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me intervistën e thelluar (in-depth interview) dhe rëndësia e saj shtrihet në aspekte të ndryshme.

Çfarë është intervista e historisë gojore dhe si u zhvillua ajo si metodologji?

Bazuar në publikimin mbi “*Historinë Gojore*” nga Robert Perks dhe Alistair Thomson “projekti i parë i historisë gojore filloi në Columbia University në Nju Jork, në vitin 1948, me regjistrimet e arkivuara me meshkuj të racës së bardhë...” (Perks & Thomson 2003: 1). Rreth asaj kohe, në vitet 1950 dhe 1960, në Britani, pionierët e historisë gojore ishin më shumë të interesuar në regjistrimin e përvojave të të ashtëquajturve njerëz “të thjeshtë”, përfaqësues të klasës punëtore (Po aty). Vetëm nga fundi i viteve 70-të, historia gojore ishte shpërndarë si pjesë e projekteve të arkivimit dhe njëhej nga akademikët e komunitetit të historianëve në disa vende të botës” (Po aty: 3).



Kol Gjon Jubani duke ndarë historinë e tij familjare në kuadër të projektit "Unë dëshmoj". © IDMC


Sipas Perks dhe Thomson, historia gojore ka pasur një ndikim domethënës në praktikën historike të gjysmës së dytë të shekullit XX dhe "ka demokratizuar studimin e së shkuarës duke regjistruar përvojat e njerëzve që kanë qenë "në hije të historisë" (Po aty: ix). Ata e shohin historinë gojore si "intervistim me pjesëmarrjen e **dëshmitarëve okularë**, në ngjarje të së shkuarës, për qëllime të rindërtimit historik" dhe pajtohen se ka pasur një ndikim të rëndësishëm në historinë bashkëkohore, siç vihet re dhe nga përdorimi i metodës së historisë gojore në shumë vende.

Ndërsa Valerie Raleigh Yow në volumnin e dytë *"Regjistrimi i historisë gojore - Një Guidë për Shkencat Shoqërore dhe Humane"*, publikuar në vitin 2005, e përkufizon historinë gojore si regjistrim të dëshmimeve personale, të transmetuara në mënyrë gojore. Ajo përdor disa terma të tjerë në përkufizimin e historisë gojore si: "**intervista e thelluar**" (*in-depth interview*), **kujtesë e regjistruar** (*recorded memoir*), **histori e jetës** (*life history*), **rrëfim i jetës** (*life narrative*), **kujtime të regjistruara** (*taped memories*), **rishikim i jetës** (*life review*), duke nënkuptuar se është dikush tjetër i përfshirë, i cili përcakton temën dhe frymëzon narratorin të fillojë të kujtojë, që regjistron e prezanton fjalët e narratorit" (Raleigh Yow 2005: 3).

Në veçanti, ajo argumenton se "intervista e thelluar, e regjistruar, ose historia gojore është një metodë kërkimi specifike brenda kuadrit të përgjithshëm të metodave cilësore (...), por se ajo është në mënyrë të pashmangshme subjektive: subjektiviteti i saj është njëkohësisht vendimtar për të kuptuar domethënien që i japim të kaluarës dhe të tashmes" (Po aty: 23). Ajo thekson se të nxjerrësh kuptime nga përvojat e jetuara është detyrë e rëndësishme e kërkimit cilësor dhe veçanërisht e intervistave të historisë gojore, sepse intervista e thelluar ofron një avantazh të të parit në një kompleksitet të plotë të botës së dikujt tjetër (Po aty). Edhe Perks dhe Thomson shprehin se intervistat janë të rëndësishme sepse ato dokumentojnë "aspekte të veçanta të përvojës historike që gati mungojnë nga burime të tjera, si marrëdhëniet personale, puna shtëpiake apo jeta familjare..." (Perks & Thomson 2003: ix).

Ata theksojnë se në projekte të caktuara të historisë gojore "qëllimi parësor ka qenë fuqizimi i individëve ose i grupeve shoqërore përmes procesit të kujtimit dhe riinterpretimit të së kaluarës, me theksin te vlera e procesit, po aq sa edhe te produkti historik" (Po aty). Nëse do të marrim si shembull projektin e IDMC-së, "Unë Dëshmoj", synimi ka qenë integrimi i ish të përndjekurve dhe të burgosurve politikë të diktaturës komuniste në vlerësimin e kujtesës historike. Përvoja e tyre individuale është trajtuar si një mjet i rëndësishëm për zbulimin dhe eksplorimin e të shkuarës nga burime autentike duke lidhur kontekstin e kohës së atëherme me të sotmen dhe, duke lejuar një riinterpretim të ngjarjeve që kanë ndodhur.

Përdorimi i intervistave si burim autentik pranohet nga historianët profesionistë në përputhje të plotë me standardet shkencore (Thomson 2003: 22). Sipas Thomson, historia gojore si një mjet për transformimin e përmbajtjes dhe qëllimit të historisë "mund të përdoret për të ndryshuar fokusin e historisë në vetvete dhe për të hapur fusha të reja studimi. Ajo mund të thyjë barrierat midis mësuesve dhe nxënësve,



Pjesa 3, "Përpjekjet për shkollim në Shkodër dhe kujtimet në rrugën Teuta"



Faqja online e projektit "Unë dëshmoj" në www.observatorikujteses.al © IDMC

midis brezave, mes institucioneve arsimore dhe botës jashtë. Dhe në shkrimin e historisë, qoftë në libra, në muze, në radio dhe në film, ajo mund t'u japë dëshmitarëve të kohës një vend kryesor në histori nëpërmjet fjalës së tyre" (Thomson 2003: 22).

KAPITULLI 2

NJË SHËNIM PËR ETIKËN PARA SE TË FILLONI TË PËRDORNI HISTORINË GOJORE

Siç përcaktohet edhe nga titulli i këtij kapitulli, përpara se të mbledhim dëshmi të historisë gojore, të cilat mund të ruhen në arkiva dixhitale ose fizike, është e nevojshme të garantojmë të drejtat e personave, të cilët ndajnë me ne historitë e tyre, si dhe t'i njohim ata me mënyrën se si do të përdoret ky material. Disa të drejta, për shembull, përfshijnë mbrojtjen e të dhënave personale ose mbrojtjen e të drejtës së autorit (copyright) mbi dëshminë e historisë gojore. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të përgatitet një marrëveshje mirëkuptimi (memorandum of understanding) me personat që intervistojmë, në përputhje me rregullat e bordeve etike, si dhe me ligjet që trajtojnë të dhënat personale dhe të drejtat e autorit.

Në këtë kapitull do të paraqesim shkurtimisht mënyrën si funksionojnë bordet etike lidhur me projekte të historisë gojore, si dhe do të hedhim një vështrim praktik mbi ligjin për të dhënat personale në Shqipëri. Ky kapitull u drejtohet në veçanti studiuesve të rinj dhe mësuesve të shkollave të mesme, të cilët dëshirojnë të zhvillojnë sistematikisht intervista të historisë gojore dhe t'i shpërndajnë këto të dhëna nëpërmjet një studimi ose për shembull, një arkivi në internet. Më shumë informacion mbi të drejtat e autorit dhe pëlqimin e të intervistuarit mund të gjeni në kapitullin tjetër (Kapitulli 3, hapi 1 dhe 4).



Një hap i rëndësishëm në procesin e historive gojore është përgatitja e marrëveshjes së mirëkuptimit.
© Jonathan Eaton.

Etika e kryerjes, përdorimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së historive gojore

Ndërsa historia gojore është praktikuar në mënyrë rigoroze që nga mesi i shekullit të 20-të, ata që e kanë përdorur atë, kanë ngritur vazhdimisht pyetje mbi konsideratat ligjore dhe etike që duhet të merren parasysh për të mbrojtur të intervistuarit përmes ligjeve mbi të dhënat personale dhe bordeve etike, siç është rasti i bordeve të rishikimit institucional dhe bordeve të etikës së kërkimit shkencor. Synimi i ngritjes së këtyre bordeve ka qenë shqyrtimi i qëllimit dhe metodologjisë së mbledhjes së historive gojore. Nga ana tjetër, ato u kushtojnë një vëmendje të veçantë pjesëmarrësve të përfshirë në studim, rreziqeve potenciale që mund t'u kanosen aktorëve pjesëmarrës dhe mënyrës se si ato mund të minimizohen. Bordet e etikës monitorojnë gjithashtu planifikimin e projektit, analizën dhe menaxhimin e të dhënave dhe **konfidencialitetin**.

Historikisht, këto masa u zhvilluan në përgjigje të dëmit fizik dhe fiziologjik të kërkimeve bio-mjekësore të kryera në shekullin e 20-të, p.sh. studimi i Tuskegee mbi sifilizin ose eksperimentet naziste mbi viktimat e Holokaustit. Rritja e kontrolleve rigoroze, sidomos në aspektet bio-mjekësore deri në anonimizimin e subjekteve njerëzore, fatkeqësisht, ka shërbyer në disa raste për të punuar kundër një prej objektivave kryesorë të metodologjisë së historisë gojore, siç është *mbledhja dhe ruajtja* e "informacionit historik përmes intervistave të regjistruara me pjesëmarrës të ngjarjeve historike të së kaluarës dhe mënyrat e jetesës" (OHA/AHA 2003).

Prandaj përpara se të kryeni kërkime akademike me persona konkretë - të tilla si intervistat me dëshmitarë okularë - ose të vendosni të publikoni historitë gojore të grumbulluara nga nxënësit/studentët gjatë një aktiviteti në shkollë, shqyrtoni rregullat dhe ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale sipas rregullave të kërkimit shkencor (Ritchie 2001).

"Mbi mbrojtjen e të dhënave" në Shqipëri

Në këtë pjesë synojmë të paraqesim një panoramë të ligjeve ekzistuese në Shqipëri, të cilat duhen mbajtur parasysh kur përdorim historinë gojore në shkolla të mesme apo në projekte kërkimore. Informacionet e mëposhtme janë më shumë të natyrës praktike për përdoruesit dhe nuk marrin përsipër t'i analizojnë të gjitha aspektet ligjore që mund të implikojnë në mënyrë afatgjatë një marrëveshje mes palëve.

Pavarësisht njohjes që mund të kenë me personin që po intervistoni, mos harroni ta pyesni atë mbi pëlqimin e tij paraprak, përpara se të kryeni një intervistë për projektin e historisë gojore. Për më shumë informacion në lidhje me dakordësimin mes palëve dhe llojin e informacionit që duhet të siguroni mbi bashkëbiseduesin tuaj, ju lutemi shihni kapitullin e tretë.

Në Shqipëri, ndryshe nga shembujt që sollëm më sipër nga SHBA, nuk ekzistojnë borde formale që të rishikojnë, posaçërisht nga ana etike, projektet kërkimore, por vepron ligji për mbrojtjen e të dhënave personale: "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me Ligjin nr. 48/2012, datë 26.04.2012

Ky ligj mbron të drejtën e njerëzve për **privatësinë** e tyre duke përcaktuar një sërë rregullash për mbrojtjen dhe përpunimin ligjor të të dhënave personale ose çfarëdolloj informacioni që lidhet me identitetin e një individi. Në kontekstin e këtij ligji, përpunimi i të dhënave personale i referohet çdo veprimi që ka lidhje me mbledhjen, organizimin, ruajtjen, përdorimin ose shpërndarjen. Ky ligj nuk është shkruar posaçërisht për studime që janë bazuar mbi historinë gojore. Por, është një ligj organik që mbulon, gjithashtu, përdorimin e të dhënave nga institucionet publike dhe ato private.

Sipas këtij ligji, ata që përpunon ose kontrollojnë të dhënat personale duhet të kenë parametra të përcaktuar qartë për mbledhjen dhe përdorimin e këtyre të dhënave, duke përfshirë edhe përcaktimin se përse u nevojitet ky informacion (nëse ai është sensitiv ose jo) dhe, për sa kohë planifikojnë ta përpunojnë këtë informacion. Përveç kësaj, individët ose institucionet që planifikojnë të punojnë me të dhënat personale duhet të kërkojnë paraprakisht pëlqimin e deklaruar, përpara se të veprojnë me të dhënat personale. Veçanërisht, ky ligj kërkon të mbrojë të drejtat e individëve lidhur me konfidencialitetin, të kuptojë qëllimin e mbledhjes së të dhënave dhe të informohet se si do të përpunohen të dhënat e tyre.

Individët dhe organizatat, të cilët në mënyrë formale kontrollojnë dhe aksesojnë të dhëna personale të tjerëve duhet të njoftojnë Zyrën e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Nëpërmjet një formulari online (http://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/formular_njoftimi-1.pdf)

Më shumë informacione mbi Zyrën e Komisionerit dhe ligjin nr. 9887 gjenden në faqen e tyre të internetit: <http://www.idp.al/>.

Edhe nëse ky ligj nuk mund të zbatohet drejtpërdrejt në një projekt të historisë gojore ose në një detyrë shkolle, ai paraqet të dhëna të rëndësishme mbi mënyrën se si duhet t'i qasemi personave që duam të intervistojmë.

Para se të nisni udhëtimin tuaj për të përfshirë dëshmitë e historisë gojore në studimin që do kryeni ose në programin shkollor, kujtohuni të keni parasysh këto tre gjëra:

1. *A do ta publikoni identitetin e individëve që do intervistoni?*
2. *Cilat mund të jenë rreziqet e mundshme për pjesëmarrësit në studimin tuaj? Nëse po, çfarë do të bëni për t'i minimizuar ato?*
3. *A ka ndonjë protokoll apo ligj vendas që duhet të keni parasysh? Nëse jo, vazhdoni të respektoni të drejtat e individëve dhe të kërkon pëlqimin e tyre përmes deklaratës me shkrim.*

Deri këtu, kemi paraqitur një arsyetim të origjinës së historisë gojore, nevojën për të konsideruar implikimet etike, si dhe të kuptojmë të drejtat e pjesëmarrësve në projektin tonë. Kapitulli 3 do të trajtojë disa hapa bazë, por shumë të nevojshëm për të zhvilluar intervistat e historisë gojore. Gjithashtu, ky kapitull do të eksplorojë në detaje shumë praktike disa çështje që janë ngritur në këtë kapitull, si: nevoja për të diskutuar mbi projektin me të intervistuarit e mundshëm dhe marrja e pëlqimit të tyre për t'u përfshirë në projekt, si dhe arritja e një marrëveshjeje mbi mënyrën se si do të përdoren të dhënat e tyre.

KAPITULLI 3

PROCESI I INTERVISTIMIT NË HISTORINË GOJORE

Në këtë kapitull do të shpjegojmë procesin e intervistimit në historinë gojore si elementi bazë për përfitim e kujtesës individuale. Gjithashtu, do të sqarojmë aspekte teknike të bisedës, hapat përgatitorë, ruajtjen e konfidencialitetit mes palëve përmes një marrëveshjeje me shkrim. Si dhe qartësimin e të drejtave të autorit për të dhënat e mbledhura.

Intervista me dëshmitarë të kohës përmbledh disa aspekte komplekse që ndikojnë situatën në të cilën ajo zhvillohet dhe që nuk garantojnë automatikisht suksesin. Por, intervistimi në vetvete është një aftësi që mund të përmirësohet përmes ushtrimit të vazhdueshëm. Ky është edhe synimi i këtij kapitulli, të ofrojë sugjerime që lehtësojnë procesin e mbledhjes së dëshmimeve. Sidomos për nxënësit dhe studentët kjo është një mënyrë e mirë për ta njohur historinë jo vetëm nga librat, por përmes rrëfimit, pyetjeve dhe përgjigjeve të personave që e kanë përjetuar atë. Kështu, ata nuk janë më vetëm konsumatorë të shifrave, fakteve dhe të dhënave, por kthehen në pjesëmarrës aktivë në këtë proces. Intervista gojore me dëshmitarë të kohës, nga ana tjetër, të jep mundësinë të takosh përfaqësues të brezave të ndryshëm dhe të njohësh këndvështrime të ndryshme mbi botën, duke ridimensionuar vazhdimisht botëkuptimin tënd mbi konceptet e tolerancës, lirisë, respektit ndaj njeriut etj. Gjithashtu, bisedat me dëshmitarët japin

mundësinë që ngjarje të mësuara vetëm përmes librave të plotësohen me dëshmi të jetuara të një periudhe të caktuar kohore duke ofruar kështu një perspektivë tjetër të asaj që kemi lexuar dhe duke i shtuar dimensione të tjera interpretimit të ngjarjeve të së shkuarës.

Hapi i parë: Faza përgatitore (gjetja e temës dhe e dëshmitarit)

Para se të intervistohen dëshmitarët e kohës ka rëndësi të përcaktohet çështja apo ngjarja historike që dëshirojmë të trajtojmë. Çdo intervistë natyrisht transmeton në mënyrë subjektive atë që ka ndodhur përmes përjetimeve personale. Këtë element duhet ta kemi parasysh që të shmangim pritshmëri të gabuara dhe të pretendojmë për një objektivitet, në thelb të pamundur. Por është e rëndësishme që përpara se të fillojmë intervistat, të bëjmë hulumtime dhe të mbledhim sa më shumë informacione të jetë e mundur, përfshi këtu edhe dokumente të ndryshme. Sepse, në thelb, historia gojore është një nga metodat e kërkimit në lëmin historik. Kur i kemi mbledhur informacionet e

Gjatë diskutimit paraprak me një dëshmitare të kohës në zonën e Valbonës për të përcaktuar çfarë do të trajtohet në intervistë. © IDMC



nevojshme për ngjarjen, mund të merremi me kërkimin e personave që kanë qenë dëshmitarë okularë të ngjarjes dhe që dëshirojnë të rrëfejnë përjetimet e tyre.

Kësisoj, personat që përzgjedhim për intervistën duhet të selektohen në mënyrë të tillë që të ofrojnë informacione dhe të dhëna jetësore unike që ilustronë më së miri një moment ose ngjarje të caktuar historike. Këto rrëfime përmbajnë ndjenjat e tyre, shpresat dhe ankthet. Disa aspekte i kujtojnë saktë, të tjera mund t'i kenë harruar krejt. Gjithsesi, të mos harrojmë që rrëfimi bëhet nga perspektiva e tyre.

Nëse duam, për shembull, të analizojmë "Revoltën në Burgun e Spaçit" (21-23 maj 1973), duhet të bëjmë kërkimet paraprake për ngjarjen duke hulumtuar fillimisht në internet, më vonë në botimet e specializuara pranë ISKK, në arkiva ose në qendra të tjera kërkimore.

Kë të intervistojmë?

Ku t'i gjejmë personat që kanë diçka për të treguar? Në rastin e "Revoltës së Spaçit" do të kërkonim te shoqatat e ish të burgosurve politikë ose IIPP një listë të personave që kryenin dënimin në burgun e Spaçit në atë periudhë dhe adresat e tyre apo numrat e telefonit. Më pas do lidheshim me ta dhe do t'u shpjegojmë projektin. Është e rëndësishme që personat ta dinë që në fillim synimin tonë dhe të bien dakord në parim me intervistën, në mënyrë që të shmangen keqkuptimet dhe zhgënjimet më vonë. Por në shumë raste, personat që kanë përjetuar ngjarje të rëndësishme mund të ndodhen afër nesh, në familje, në rrethin shoqëror dhe na motivojnë për t'i intervistuar vetëm duke dëgjuar historitë që rrëfejnë. Në një rast tjetër, mund të jetë tema që trajtohet në shkollë, ajo që i shtyn nxënësit të kontaktojnë dëshmitarët e kohës. Në të gjitha rastet, **intervistuesi** duhet të ketë përgatitur një listë pyetjesh dhe të ketë menduar renditjen e tyre. Pavarësisht informacioneve që

i japim me gojë personit që do të intervistojmë, mund të përgatisim edhe një përmbledhje më shkrim të pikave kryesore që do të pyesim gjatë intervistës dhe në fund të sigurohemi që pala tjetër e ka kuptuar qëllimin e projektit.

Sfondi personal

Para intervistës duhet ta njohim mirë personin me të cilin do të bisedojmë, sfondin e tij personal. Kur janë personalitete të njohur mund të hulumtojmë fillimisht në internet (google), ose të pyesim shokë, mësues apo persona të tjerë që mund t'i njohin. Kështu do të kemi një panoramë më të plotë për personin përballë.

Gjatë procesit të intervistimit mund të ndodhë që na rrëmben biseda dhe në fund të harrojmë të shënojmë të dhënat personale të të intervistuarit. Prandaj dokumentimi dhe renditja e saktë e informacioneve që duam në lidhje me personin rekomandohet të plotësohen qysh në fillim:

- Emri /Mbiemri
- Ditëlindja (mosha)
- Vendlindja
- Vendbanimi në momentin kur ka përjetuar ngjarjen
- Sa vjeç ishte p.sh kur u burgos/u arrestua/u arratis?
- Sa vjeç ishte kur ndryshoi sistemi politik?
- Në varësi të rastit mund të pyeten edhe për besimin fetar, për përkatësinë etnike etj.

Sfondi historik dhe gjeografik

Përveç informacioneve biografike mbi personin që do intervistojmë, është e rëndësishme të njohim kontekstin historik të ngjarjes që do trajtojmë. Vetëm kështu mund ta kuptojmë të intervistuarin dhe ato që ai tregon. Për shembull, nëse dikush tregon për "rrëzimin e bustit" duhet

ta dimë, pa u menduar gjatë, se bëhet fjalë për rrëzimin e monumentit të diktatorit Hoxha më 20 shkurt 1991, në qendër të Tiranës. Kur flitet për “tollona” dhe “racione” të dimë që bëhet fjalë për urinë që pllakosi në Shqipëri pas prishjes së saj me Bashkimin Sovjetik dhe bllokun komunist të Lindjes. Dhe kur pyesim për “tragjedinë e Otrantos” duhet të kemi njohuri paraprake për ngjarjen e 28 marsit 1997 ku një anije shqiptare me 57 pasagjerë u mbyt pranë brigjeve italiane.

Gjithashtu, në disa raste, do të na duhet të sqarojmë pozicionin gjeografik të vendit ku ka ndodhur një ngjarje e caktuar ose edhe për të njohur vendet që përmenden në rrëfimin e personit që po intervistojmë. E rëndësishme është se gjatë intervistimit, bazuar në historinë gojore, të pyesim dhe të sqarojmë edhe ato aspekte që mund të na duket se i dimë përmendësh. Siç thotë sociologu francez Pierre Bourdieu, këtu kemi të bëjmë me “kuptimin e këndvështrimeve të ndryshme ndaj botës dhe ngjarjeve të saj, duke vënë përherë në pikëpyetje faktet që i quajmë të njohura” (Bourdieu 1997: 773-802). Këtë proces e quajmë kontekstualizim historik.

Hapi i dytë: Intervistimi

“Thyerja e akullit”

Para se të fillojmë bisedën, përveç **pyetjeve specifike** të tipit “Kush? Kur? dhe Ku?” është mirë të kemi përgatitur disa **pyetje të hapura** kryesisht me “Si?”, “Pse?” (na tregoni si ishte historia... na shpjegoni pse ndodhi situata... na tregoni mbi jetën tuaj deri në momentin kur...). Natyrisht në varësi të disponueshmërisë fizike të dëshmitarit okular, pyetjet ndonjëherë mund të dërgohen edhe me e-mail. Por, intervista përballë të lejon ndërhyrjen dhe përjetimin emocional në bisedë, pyetjet dhe reagimin direkt të tyre. Gjatë bisedës paraprake, ose gjatë intervistës mund të kërkohen dëshmi dhe materiale arkivore, fotografi,

ditarë, letra apo dokumente të tjera që e bëjnë më autentik rrëfimin. Për dokumentet origjinale mund të bëhen fotokopje që i bashkangjiten intervistës së botuar apo të transmetuar.

Organizimi i intervistës dhe shënimet

Pasi është rënë dakord për regjistrim me video apo audio të bisedës, me pëlqimin e personit që do të intervistohet përcaktohet data për intervistën, sa do të zgjasë dhe ku do të realizohet ajo. Sipas OHS (2012: seksioni 3) duhet rënë dakord paraprakisht për detaje si prania e personave të tjerë në intervistë që zakonisht nuk është e nevojshme, temat që do të mbulohen dhe **vendi** ku do të mbahet intervista. Zakonisht sygjerohet një vend i qetë, si shtëpia e të intervistuarit, por edhe vende të tjera që ata i preferojnë.

Kohëzgjatja e një interviste varet nga shumë faktorë, nga mënyra e të folurit të një personi, nga rëndësia e çështjes që trajtohet, si dhe nga koha që ka në dispozicion secila palë. Minimalisht, për kryerjen

Biseda paraprake me dëshmitarët okularë në shtëpinë e tyre. © IDMC



Njësoj si në intervistat gazetareske, edhe me dëshmitarët e kohës fillohet biseda me pyetje të përgjithshme (të hapura), për të krijuar një atmosferë bashkëpunimi dhe për ta çtensionuar situatën. Nëse nuk marrim përgjigje menjëherë, i rikthehemi pyetjeve, ose kur nuk kuptojmë një term apo një fjalë, kërkojmë shpjegime.

Nuk duhet të harrojmë që i intervistuari ka të drejtën e tij të mos i përgjigjet të gjitha pyetjeve nëse e sheh të arsyeshme. Ose dëshiron të mos flasë për çështje të caktuara. Rëndësi ka që personi përballë nesh të kuptojë dhe të ndjejë që nuk po detyrohet të rrëfejë gjëra që nuk dëshiron t'i thotë dhe se ai është i lirë të kontrollojë rrjedhën e bisedës dhe/ose ta ndërpresë fare atë, nëse e quan të arsyeshme.

fotografimin etj. Kjo quhet ndarje e punës dhe u mëson të rinjve se si të bashkëveprojnë në grup. Sidomos kur intervista bëhet me persona të familjes ose të njohur rekomandohen dy veta, meqënëse siç dihet edhe nga studimet sociologjike (Bourdieu 1997, 773-802; Morrissey 2003,

e një interviste mund të llogarisim një orë kohë. **Regjistrimi** me smartphone, diktofon apo mjete të tjera audiovizive lehtëson procesin e punës, por mund të mbahen edhe shënime në bllok. Sidoqoftë regjistrimi digjital ka përparësi se mbetet në çdo moment i aksesueshëm nga përdoruesi edhe shumë vite më vonë. Gjatë intervistës mund të fotografojmë bisedën apo personin përballë, por në çdo rast duhet të marrim leje nëse mund t'i përdorim fotografitë si ilustrim i bashkëpunimit dy palësh.

Në të gjitha rastet rekomandohet që të fillohet me regjistrimin e emrit të personit, vendit ku kryhet intervista, datën dhe temën në fjalë.

Për nxënësit shtrohet pyetja nëse duan ta bëjnë bisedën (intervistën) vetëm apo në grup. Ndonjëherë është më e lehtë që dikush të bëjë pyetjet dhe tjetri të kujdeset për "technikën" që nënkupton regjistrimin me diktofon, filmimin,

107), disa pyetje nuk bëhen dhe disa përgjigje nuk jepen sipas logjikës që në familje nuk flitet për këto gjëra!

Pyetjet dhe përgjigjet

Fillimisht, personit që po intervistojmë, i prezantojmë synimin e intervistës. Në rastin e projektit digjital të IDMC, "Unë dëshmoj" (www.observatoriikujteses.al), për mbledhjen e historisë gojore u morën dëshmitarë të periudhës komuniste, ish të përndjekur, ish të burgosur, persona që në forma të ndryshme kanë vuajtur persekutimin gjatë diktaturës, personalisht apo prej familjes. Ata u njohën me projektin, çfarë synonte dhe cili është kontributi që duhet të japin personat e intervistuar, si dhe përfitimet e tyre nga ky projekt.

Për çdo intervistë, intervistuesi përgatit listën e pyetjeve (gjysmë të strukturuar) si rezultat i kërimit paraprak që ka kryer. Por, megjithatë, ai qëndron i vëmendshëm që të ndërhyjë me pyetje të reja, sa herë i krijohet mundësia nga personi që ka përballë. Ndryshe nga intervista gazetareske që ka interes publik dhe gazetari mund ta ndërpresë personin që ka përballë duke i bërë një pyetje provokative, në rastin e dëshmime gojore biseda është më delikate dhe ka natyrë më private. Janë personat që rrëfejnë momente shumë personale dhe përjetime mbase edhe të dhimbshme, prandaj intervistuesi duhet të tregohet i ndjeshëm dhe fleksibël në çdo moment. Intervistuesi

Në përgjithësi, intervistat për "Unë dëshmoj" u mbyllën brenda takimit të parë, por në disa raste u pa e nevojshme të kishte takime të mëtejshme për të sqaruar data dhe ngjarje, dhe për t'i pasuruar dëshmitë me dokumente arkivore.

Gjatë intervistave për "Unë dëshmoj" të intervistuarit shpeshherë duhet ta ndërprisnin regjistrimin për shkak të ngarkesës emocionale. Regjistrimi rifillonte me lejen e tyre kur ndiheshin gati të vazhdonin rrëfimin.

duhet të dijë si të përballojë edhe situata të tilla, të paplanifikuara. Dëgjimi me vëmendje dhe ndërhyrja në çastin e duhur është garancia e suksesit të intervistave që mbledhin historinë gojore.

Hapi i tretë: Analiza e intervistës dhe prezantimi i rezultateve

Pas intervistës mund të bëjmë një “zbardhje” të saj të detajuar, por edhe mund ta përmbledhim atë në vija të përgjithshme duke evidentuar momentet më të rëndësishme. Përzgjedhja bëhet në varësi të çdo rasti dhe synimit tonë final se për çfarë duam ta përdorim dëshminë gojore. Përshkrimin e gjestikulacionit të personit (“tund kokën”, “mohon” etj.) është mirë ta përfshijmë në materialin e transkriptuar për ta bërë sa më autentik rrëfimin, por mund të heqim përsëritjet e shprehive mbushëse si “hëm”, “hëh”, “ashtu” etj. Sidomos për nxënësit dhe studentët ka rëndësi të kuptohet që shprehja e opinionit të tyre personal në lidhje me intervistën, duhet të shënohet veçmas dhe të mos përzihet me dëshminë gojore. Pajisja e dëshmisë me një tekst hyrës me të dhëna pikante mbi personin dhe ngjarjen e bën më të lehtë leximin e saj. Po ashtu një analizë e përmbajtjes dhe e narrativës i sqaron dimensionet e ndryshme të intervistës.

Analiza e përmbajtjes

Përmes intervistave të historisë gojore ne mund të rindërtojmë një realitet të shkuar në të tashmen, siç ndërtohet një puzzle. Përmes metodës krahasuese mund të vëzhgojmë se si dëshmitarë të ndryshëm mbajnë qëndrime të ndryshme ndaj ngjarjeve të njëjta. Sepse historia nuk mund të rrëfëhet bardhezi dhe nuk është një-dimensionale.

Analiza e narrativës historike

Një ngjarje të caktuar historike në të shkuarën ne mund ta gjykojmë dhe analizojmë përmes këndvështrimeve dhe pozicioneve të ndryshme që mbajnë dëshmitarët në historinë gojore që rrëfejnë. Kësisoj mund të gjykojmë qëndrimin e tyre në të shkuarën.

Analiza e vlerave

Përmes krahasimit të gjetjeve nga dëshmitë gojore dhe përvojës së përftuar gjatë intervistimit, mund të reflektojmë në mënyrë kritike për qëndrime të caktuara që shoqëria mban sot kundrejt historisë. Nëse do ishim ne në vendin e këtyre personave, si do vepronim atëherë? Po sot a do vepronim ashtu?

Përmes këtyre analizave synohet, tekefundit, kritika e burimeve, një metodë kjo që nxënësit e njohin nga ora e historisë në klasë.

Çfarë mësojmë nga mbledhja e historive gojore?

- Mësojmë të formulojmë pyetje (historike) në mënyrë të mëvetësishme dhe të kërkojmë e të gjejmë dëshmitarë okularë;
- Mësojmë të rendisim pyetjet sipas rëndësisë dhe kuptimit që ato kanë në një intervistë;
- Mësojmë të zbardhim një histori gojore, ta përmbledhim atë apo ta sistematizojmë përmes dokumentimit, analizës dhe gjykitimit të saj;
- Mësojmë të kontrollojmë në mënyrë kritike intervistën, perspektivat që na kanë ofruar pyetjet tona dhe përgjigjet e të intervistuarit;
- Mësojmë të analizojmë intervista të ndryshme, nga persona të ndryshëm për të njëjtën ngjarje, të shohim dallimet dhe ngjashmëritë mes tyre;
- Mësojmë të vlerësojmë dëshmitë gojore dhe kujtimet e dëshmitarëve okularë si pjesë integrale e dokumentimit historik.

Hapi i katërt: Marrëveshja e mirëkuptimit mes palëve dhe e drejta e autorit

Sipas OHS të gjitha projektet e historisë gojore, intervistuesit, studiuesit dhe kujdestarët apo personat përgjegjës në arkiva, muze dhe biblioteka që mbajnë materiale të historisë gojore, kanë nevojë për autorizim të qartë për përdorimin e këtyre materialeve, përndryshe nuk mund të justifikojnë kohën dhe përpjekjet e nevojshme për ruajtjen, dokumentimin dhe arkivimin e tyre. Intervistuesit dhe institucionet si muzetë duhet të kërkojnë nga të intervistuarit të japin të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera me shkrim, dhe të bëjnë të qartë aprovimin e tyre për përdorim dhe akses duke plotësuar dhe nënshkruar një marrëveshje.

Një marrëveshje mirëkuptimi me shkrim e firmosur nga ana e përfaqësuesëve të projektit apo mes intervistuesit dhe të intervistuarit mund të zëvendësojë marrëveshjen e regjistrimit (shih foton në faqen tjetër: Marrëveshje mirëkuptimi).

Në rastin e projektit të IDMC [“Unë Dëshmoj”](#), në marrëveshjen e mirëkuptimit është rënë dakord për publikimin e intervistës dhe përdorimin e saj të pakufizuar dhe falas, në kuadër të projektit, me synimin për të mbështetur mësuesit e historisë në mbarë Shqipërinë, duke iu ofruar materiale shpesh nga persona që kanë vuajtur dënimin dhe persekutimin gjatë diktaturës. Ndër të tjera, të intervistuarit në këtë marrëveshje, autorizojnë IDMC të përdorë fotografitë e bëra gjatë intervistës si dhe fotografi të sendeve të tyre personale që lidhen me persekutimin e tyre, të cilat vijnë si materiale ilustruese të historisë së tyre.

Marrëveshja e mirëkuptimit përgatitet nga grupi i punës dhe i dërgohet personit që do të intervistohet ta shoh atë paraprakisht, në rastin më



MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Unë,, jap pëlqimin dhe pajtohem me publikimin e intervistës dhe përdorimin e saj të pakufizuar dhe falas në kuadër të projektit “Unë dëshmoj!” nga IDMC-Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (www.idmc.al).

Ky projekt synon të mbështesë mësuesit e historisë në mbarë Shqipërinë duke iu ofruar materiale shpesh nga persona që kanë vuajtur dënimin dhe persekutimin gjatë diktaturës. Përveçse do të vendosen pjesë të intervistave në faqen online të IDMC, personat e intervistuar do kenë mundësinë të ftohen në takimet që IDMC organizon me të rinjtë në qytetet ku ata ndodhen, si dhe në shkollat e interesuara.

Unë, gjithashtu i jap leje IDMC të përdorë dokumentet e mëposhtme:

- ☐ Fotot e marra gjatë intervistës;
- ☐ Fotografitë ose objektet që i kam dhënë hua organizatorëve të projektit;

Përtej dakordësisë sime në lidhje me përdorimin sa më sipër, përjashtim bëjnë:

.....

Data:

Nënshkrimi (i/e intervistuari/a)

Nënshkrimi (Ekipi i projektit)

.....

www.idmc.al • Tel: +355 44521899 • Email: office@idmc.al
 Address: Bardhok Biba Street, Entrance A, 11th Floor, Ap.36, Tirana, Albania

Marrëveshje mirëkuptimi e përgatitur nga IDMC në kuadër të projektit “Unë dëshmoj”

të keq ajo i prezantohet atij para fillimit të intervistës. Në rast se palët nuk bien dakord, kanë mosmarrëveshje apo dëshirojnë të negociojnë ndonjë pikë të marrëveshjes, intervista nuk mund të kryhet pa u dakordësuar palët. Kur personi që intervistohet nuk ka kontestime në lidhje me marrëveshjen, ajo firmoset në dy kopje nga ana e të intervistuarit dhe intervistuesit.

Qartësimi i të drejtave të autorit për të dhënat e mbledhura

Përgjegjësia e intervistuesit vazhdon edhe pas intervistës në sqarimin e të drejtave të autorit me personin e intervistuar. Sipas OHS (2012, seksioni 5) në fund të intervistës, të intervistuarit i duhet rikujtuar:

- e drejta e autorit (transfer of copyright)
- marrëveshjet që janë bërë për kujdesin dhe ruajtjen e intervistës dhe materialit shoqërues, si menjëherë dhe në të ardhmen, dhe të çdo përdorimi të mundëshëm të intervistës në të ardhmen
- nëse kërkon ndonjë kufizim në përdorimin ose disponueshmërinë e intervistës për momentin apo në të ardhmen.

Në këtë kapitull paraqitëm teknikat e intervistimit dhe hapat konkretë për të mbledhur dhe përpunuar historitë gojore. Gjithashtu ofruam shembuj të marrëveshjes dypalëshe para se të fillojë procesi i intervistimit. Në kapitullin e ardhshëm (4) do të shohim nga afër si zhvillohen projektet e historisë gojore dhe gjithë specifikat e planifikimit të tyre nga teoria në praktikë.

KAPITULLI 4

ZHVILLIMI I NJË PROJEKTI BAZUAR NË HISTORINË GOJORE

Në kapitujt e mëparshëm kemi trajtuar hyrjen në mënyrat e intervistimit të historisë gojore dhe rëndësinë që kanë ato në tematikën dhe mbarëvajtjen e këtyre projekteve. Në këtë kapitull do të flasim për projektet që bazohen te historia gojore, si t'i planifikojmë ato, si të kërkojmë fonde, kush do jetë stafi dhe si të zgjedhim teknologjinë më të mirë e natyrisht, më të lirë.

Projektet që bazohen mbi historinë gojore përmbajnë në vetvete shumë elementë që plotësojnë punën në këtë fushë. Planifikimi i projekteve që lidhen me historinë gojore është një element shumë i rëndësishëm në mbarëvajtjen e gjithë punës, sepse vetëm kryerja e intervistave nuk mjafton. Planifikimin për një projekt të këtij lloji mund ta ndajmë në planifikim tematik dhe në atë financiar. Kur flasim për planifikim financiar, kjo nuk lidhet domosdoshmërisht me grumbullimin e fondeve për projekte si këto. Në shkollat e mesme, sidomos, këto projekte mund të zhvillohen edhe pa asnjë fond.

Planifikimi tematik dhe shkrimi i projektit të historisë gojore

Ky planifikim ka të bëjë me temën e projektit dhe me pjesën historike të saj. Në kapitujt e mëparshëm kemi shtjelluar disi planifikimin tematik, por këtu do të prezantojmë disa aspekte thelbësore të tij. Planifikimi

tematik është i rëndësishëm sepse gjatë procesit të punës mund të dalin rezultate të paparashikuara, të cilat grupi i projektit nuk i kishte menduar më parë. Kjo nuk nënkupton gjithmonë dështimin e projektit, pasi ka raste kur pasojat e paparashikuara mund të shërbejnë për ta përmirësuar projektin, por edhe për të gjeneruar ide të reja në këtë drejtim. Gjithashtu, planifikimi tematik mund t'i ndihmojë drejtuesit e projektit të mbledhin informacione mbi elementë apo të dhëna që mund të jenë dukur fillimisht të parëndësishme, por që bëhen më kuptimplotë pas kryerjes së intervistave apo përpunimit të informacioneve të marra prej tyre. Më tepër, planifikimi ndihmon në përcaktimin e rëndësisë që ka një informacion në lidhje me temën që kemi vendosur të trajtojmë.

Të rinjtë duke diskutuar mbi intervistat e realizuara paraprakisht në kuadër të workshopit "Nostalgjia për komunizimin" Shkodër, shkurt 2017. © IDMC



Më pas, duhet përcaktuar edhe **qëllimi i projektit**, i cili në rastin më të mirë shërben si moto apo si mision i projektit. Zakonisht motoja e projektit shprehet në një ose dy fjali maksimumi. Në rastin e projektit "Zërat e Kujtesës" së ISKK motoja është: "[...] Projekti bazohet në përshkrimin cilësor më tepër sesa në atë statistikor, i cili vjen përmes përvojave individuale, ku detajet, situatat konkrete, konteksti, personazhet reale të përfshirë në to, e bëjnë jo vetëm të pakontestueshme ekzistencën e krimeve të komunizmit, por, ndihmojnë edhe analizën dhe interpretimin e mënyrës se si funksionoi ai sistem" ("Zërat e kujtesës, Vëllimi II" Kopertina e pasme, 2015).

Pjesë tjetër e pandashme e një projekti bazuar në historinë gojore është caktimi i një "vendi" ku do të mbahen materialet që do të nevojiten për projektin, por edhe ato që do të mblidhen. Kjo lloj "depoje" nuk duhet anashkaluar sepse materialet që do grumbullohen mund të jenë të shumta dhe do të kërkojnë shumë hapësirë. Drejtuesit e projektit duhet të vendosin se ku do të ruhen materialet dhe kush do të ketë pronësinë mbi to që në fazat fillestare të projektit. Depoja duhet të jetë e mjaftueshme për të mbajtur të gjithë materialet e projektit në përputhje me standardet e arkivimit, ku materialet të ruhen mirë e të mos dëmtohen. Mbani mend se interneti nuk është një depo. Mund ta përdorni për të shpërndarë informacion, por jo si një depozitë të përhershme.

Është e rëndësishme që gjatë planifikimit tematik, projekti të ketë një titull. Titulli e përcakton projektin, e bën që të njihet e prezantohet, dhe të jetë lehtësisht i identifikueshëm. Titulli duhet të jetë kuptimplotë dhe të ketë lidhje me temën dhe objektivat që caktohet për projektin. P.sh. "Zërat e Kujtesës" (ISKK), "Unë dëshmoj" (IDMC) etj.

Zakonisht, projektet e tilla në shkollat e mesme nuk kanë mundësi të paguajnë personel për zbatimin e tij. Por projekti mund të kryhet mbi baza vullnetare, sidomos kur rezultatet e tij do të prezantohen si detyra klase, projekte semestrare etj. Gjithsesi, grupi i punës mund edhe të aplikojë te sponsorë të ndryshëm me projektin për historinë gojore, për të minimizuar kostot personale.

Stafi

Stafi apo grupi i punës luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e projektit. Nuk ka ndonjë numër të përcaktuar për stafin, por shumë i rëndësishëm është motivimi i tij. Aty mund të bëjnë pjesë nxënësit, mësuesit, pjesëtarë të stafit të shkollës që kanë interes për këto lloj projektesh, studentë etj.

Projekti ka nevojë për një **drejtues projekti**, ose **koordinator**, i cili/e cila do të drejtojë projektin. Ky koordinator duhet të jetë i dedikuar, i besueshëm, taktik dhe i hapur, në mënyrë që të ketë një mbarëvajtje dhe zbatim sa më të mirë të projektit. Koordinatori e drejton projektin duke përcaktuar qëllimin, fokusin, buxhetin, tematikën e intervistave, numrin e intervistave, teknikat e përpunimit dhe

afatet në të cilat do të zbatohet projekti në tërësi. Mund të ketë edhe një bord për projektin, i cili, në shkollë, mund të ketë pjesëtarë të shkollës, prindër dhe anëtarë të komunitetit.

Përveç drejtuesit/koordinatorit, projekti ka nevojë për intervistues, transkriptues dhe staf mbështetës. Duhet theksuar se rolet e tyre duhen përcaktuar sa më mirë e sa më qartë.

Intervistuesit janë ata që do të kryejnë intervistat me dëshmitarët e kohës që do të dëshirojnë të rrëfihen. Edhe drejtuesi/koordinatori i projektit mund të kryejë intervistat, por është e rëndësishme që këto dy role të mos përzihen me njëri-tjetrin. Intervistuesit kanë përgjegjësinë

që të kryejnë kërkime përpara se të bëhen intervistat, të zhvillojnë pyetjet në bashkëpunim me drejtuesin/koordinatorin e projektit duke u bazuar gjerësisht te tema e projektit, të kryejnë intervistat, t'i përpunojnë ato dhe të dorëzojnë materialin e mbledhur te drejtuesi i projektit. Ata, në bashkëpunim me drejtuesin e projektit duhet të përcaktojnë format e të dhënave biografike të narratorit, formën për kontratën mes intervistuesit dhe narratorit.

Në variantin më të mirë të zbatimit të një projekti, del nevoja të ketë edhe **personel mbështetës**, i cili merret kryesisht me punë logjistike apo sekretarie, lë oraret për intervistat, bën telefonatat, përpilon shkresat, njeh materialet dhe pajisjet e teknologjisë. Zakonisht, për këto pozicione do ishte mirë që të gjendeshin vullnetarë. Secili pjesëtar i ekipit të projektit ka rolin e vet në një zinxhir hallkash që e plotësojnë punën e njëri-tjetrit.

Pjesë e rëndësishme e stafit mbeten transkriptuesit e intervistave. Ata kanë një punë shumë të rëndësishme për të zbardhur intervistat e kryera. Edhe pse shumë persona dëshirojnë të kenë akses te materiali i intervistave në audio ose video, **transkriptimi** i asaj çfarë është folur në to është shumë i rëndësishëm sepse vlen si dokument historik. Ndërkohë, transkriptimi vlen edhe për personin e intervistuar, i cili/e cila mund të ketë mundësi të rishikojë atë çfarë ka thënë dhe nëse nuk e ka thënë në mënyrë të qartë ta përmirësojë apo ta sqarojë më mirë.

Planifikimi financiar

Ky planifikim ka, gjithashtu, një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e projektit. Është e vërtetë se projekte të tilla mund të mos kenë financime, por burime mund të gjenden gjithmonë. Një nga këto burime mund të jetë Drejtoria e Shkollës ose vetë Universiteti apo Fakulteti. Nëse nuk gjenden burime të tilla financiare, mund t'u drejtoheni institucioneve publike, ministrive dhe organeve të tjera të

qeverisjes vendore. Edhe nëse këta nuk kanë fonde, mos u dorëzoni: organizata të shoqërisë civile, sponsorë, pjesëtarë të komunitetit mund të kenë interes të mbështesin projekte të tilla. Por, gjithashtu, fondet mund të mblidhen edhe nga vetë komuniteti me anë të donacioneve të qytetarëve. Për të kursyer marrjen me qira të pajisjeve të teknologjisë, mund të përdoren telefona *smart phone*, me të cilët mund të bësh foto apo të regjistros video. Cilësia mund të mos duket e mirë, por mjafton si një fillim. Kur shkoni të prezantoni një projekt te një sponsor, e rëndësishme është që të shprehni shumë qartë temën e projektit, të sqaroni titullin dhe moton e tij dhe të përcaktoni grupin e të intervistuarve. Dhe sigurisht, të gjithë donatorët do të ndiheshin shumë mirë nëse do të shikonin paraprakisht një pjesë të projektit, p.sh. një intervistë që është kryer, ku theksohet pse është e rëndësishme kjo temë për komunitetin.

Kohëzgjatja e projektit

Sipas formës që kemi paraqitur në shtojcën B, përcaktimi i kohëzgjatjes së projektit do të ishte i domosdoshëm për arsye të planifikimit, por edhe të zbatimit të projektit. Kjo bëhet nëpërmjet tabelës së vendosur në formën e projektit, ku do të shtjellohet në kohë periodha e zbatimit të aktiviteteve dhe detyrave të projektit (p.sh. kryerja e intervistave është një aktivitet, i cili përmban disa detyra, që mund të jenë: identifikimi i të intervistuarve, kontakti me ta, nënshkrimi i kontratave për regjistrimin, gjetja e pajisjeve për regjistrimin etj.) Tabela që kemi përgatitur është e ndarë në muaj, por mund të jetë edhe me javë.

Teknologjia e përdorur është shumë e rëndësishme për të përcaktuar kostot e projektit. Dihet se pajisjet teknologjike dhe të përpunimit të informacioneve të mbledhura janë ato që kushtojnë. Gjithë dilema për pajisjet e teknologjisë ka të bëjë nëse intervistat duhen bërë audio, si t'i kombinojmë të dyja, nëse do t'i përdornim dhe se cilat janë pajisjet që do realizojnë produktin final që pritet nga projekti. Pajisjet, të cilat

ndahen në ato të regjistrimit dhe të transkriptimit duhet të jenë sa më të përshtatshme për të regjistruar dhe për të ruajtur në mënyrën më të përshtatshme dhe cilësore produktin që na intereson. Nevojiten pajisje që të regjistrojnë qartësisht, por edhe në përputhje me buxhetin e projektit. Kamera duhet të ketë fokusin e mirë. Mikrofonat duhet të vendosen pranë intervistuesit, audio është shumë e rëndësishme, por duhet të ketë një cilësi të lartë. Pajisjet e transkriptimit janë të rëndësishme gjithashtu, sepse vetë procesi mbart në vetvete shumë përgjegjësi.

Modeli i projektit

Në formën e projekt-propozimit, siç kemi folur më sipër, duhet përcaktuar titulli i projektit. Më pas datat e fillimit dhe mbarimit dhe totali në lekë i gjithë kostove të projektit. Përveç këtyre, informacioni i përgjithshëm përmban emrin e drejtuesit të projektit dhe institucionin ku punon. Ky institucion mund të jetë shkolla ose universiteti dhe duhen përcaktuar në projekt-propozim sepse e bëjnë më të besueshëm atë, sidomos në rastet e aplikimit për fonde. Pjesa tjetër e projektit ka të bëjë me narrativën e tij. Qëllimi i projektit është i rëndësishëm për të treguar se çfarë ofron dhe siguron projekti. Qëllimi vlen për të matur edhe rezultatet që ka pasur projekti. Përshkrimi i projektit është pjesa ku duhet treguar se pse nevojitet një projekt i tillë, cilët janë përfituesit e tij, kush merr pjesë në zbatimin e tij etj. Përshkrimi i aktiviteteve të

Për regjistrimin nevojiten: kamera ose regjistruar audio, kaseta (audio ose video), kablo, bateri rezervë, karikues rezervë, mikrofonë, kartë memorie, laps, letër. Për përpunimin nevojitet kompjuter, programe montazhi, CD.

Për transkriptimin nevojiten: aparatura ku mund të shfaqet intervista, kufje, kompjuter.

Gjithmonë testoni pajisjet përpara përdorimit, sidomos ato që ju nevojiten për intervistat dhe mbani bateri dhe karikues rezervë.

projektit është i rëndësishëm sepse lidhet drejtpërdrejt me kostot që do ketë ky projekt. Përshkruani çdo gjë me detaje dhe mos harroni të përcaktoni kohën që ju nevojitet për të zbatuar aktivitetet. Buxheti duhet të përfshijë çdo detaj që parashikohet te aktivitetet, p.sh. kosto për stafin, pajisjet e regjistrimit, qiraja e sallës ku do kryen intervistat, kostot e udhëtimit etj. Te tabela duhet të jetë i detajuar përshkrimi dhe kosto sipas shembullit. Te tabela e kohëzgjatjes së projektit përcaktoni zbatimin e aktiviteteve dhe detyrave të projektit.

Projekt propozim

Titulli i projektit:

Mënyrat e emigrimit të Shqiptarëve në vitet 1990-2000

Data e fillimit: 15 shkurt 2018

Data e përfundimit: 15 maj 2018

Shpenzimet financiare (në lekë): pa pagesë

Drejtuues i projektit/ Institucioni

Mësuese: Marjana Kodra
Klasa 11 B
Shkolla e mesme e
përgjithshme

Qëllimi i projektit: (1 rresht)

Projekti ka për qëllim që të mbledhë informacione mbi mjetet dhe rrugët që kanë bërë emigrantët shqiptarë në periudhën 1990-2000

Përshkrimi dhe arsyet pse nevojitet një projekt i tillë: (15 rreshta maks.)

Nxënësit e klasës 11 B u është shpërndarë detyra që të mbledhin informacione nga familjarët, të njohur dhe qytetarë mbi mjetet dhe rrugët që kanë përdorur shtetasit shqiptarë për të emigruar jashtë Shqipërisë në periudhën 1990-2000.

Aktivitetet e projektit: (10 rreshta maks.)

Aktiviteti 1- përcaktimi i pjesëmarrësve në intervista dhe gjetja e pajisjeve për intervistimin
Aktiviteti 2- kryerja e intervistave
Aktiviteti 3- transkriptimi dhe përpunimi i të dhënave të marra
Aktiviteti 4- nxjerrja e rezultateve dhe prezantimi
Aktiviteti 5- Publikimi i të dhënave në faqen e internetit të shkollës

Model i plotësuar i projekt propozimit

Regjistri i projektit është një formular që plotësohet nga koordinatori ose stafi mbështetës i projektit. Kjo formë ka një rol cilësor në ndjekjen e ecurisë së projektit. Le të shohim me radhë: te kolona e narratorit shënohet emri, mbiemri i tij/saj; te kolona e intervistuesit shënohet emri, mbiemri i tij/saj; më pas është data e intervistës; një shënim se kur është nënshkruar kontrata; draft transkriptimi për narratorin tregon se kur ka mbaruar transkriptimi i intervistës dhe i është nisur narratorit që ta shohë. Përpunimi i të dhënave, i kryer prej kujt, është informacion me vlerë, gjithashtu. Të kolona e “Artefakte/foto/referenca” vendoset nëse ka dokumente shtesë përveç intervistës të ofruara nga narratori. Kolona “Arkivuar” tregon nëse është ruajtur intervista, transkriptimi dhe materialet e tjera.

Forma për Regjistrin e projektit

Narratori	Intervistuesi	Data e intervistës	Kontrata e nënshkruar (si shënim)	Draft transkriptimi për narratorin	Përpunimi i të dhënave (i kryer prej kujt)	Artefakte/foto/ referencia	Arkivuar
A. Kana	E. Musa	15.03.2018	Po	Po kryhet nga E. Musa	E. Musa	Foto e periudhës si emigrant, viti 1993	po
M. Lami	E. Musa	20.03.2018	Po	Po kryhet nga E. Musa	E. Musa	Foto e mbërritjes në Itali, 1991	po

Model i plotësuar i regjistrin të projektit

Raportimi dhe vlerësimi i projektit

Kjo duket si një pjesë formale e projektit, por në të vërtetë është një pjesë që ndihmon në vlerësimin e punës dhe në përmirësimin e saj në projektet e tjera që do pasojnë. Edhe pse projekti mund të jetë i vogël, përvoja, ndarja e saj me të tjerët dhe një vlerësim për gjërat që nuk shkuan si duhet, është i nevojshëm në fund. Raportimi më formal bëhet përmes një vlerësimi programatik të projektit, i cili përmban informacione nëse janë realizuar aktivitetet në kohë dhe më

e rëndësishmja, nëse është përmbushur qëllimi i projektit. Vlerësimi apo raportimi plotësohet edhe me raportin financiar. Për këtë mund të përdoret një tabelë në Excel ku të jenë detajuar të gjitha shpenzimet. Dhe mos harroni të ruani faturat. Vlerësimi vlen edhe për mësuesit, të cilët në fund duhet të vënë notë për punën e nxënësve.

Deri tani kemi folur mbi rëndësinë e planifikimit gjatë zhvillimit të një projekti bazuar mbi dëshmitë gojore. Gjithashtu, përmendëm hapat dhe elementët që duhet të kemi parasysh në planifikimin dhe në mbarëvajtjen sa më të mirë të projektit. Në kapitullin e ardhshëm do të flasim në mënyrë të detajuar se si të ruajmë dhe të publikojmë të dhënat e mbledhura gjatë projekteve të historisë gojore.

KAPITULLI 5

RUAJTJA DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NGA HISTORIA GOJORE

Në kapitullin e mësipërm kuptuam se si të zhvillojmë intervistat, si rregullohet **raporti** mes intervistuesit dhe të intervistuarit, si të ruajmë konfidencialitetin dhe të mbledhim materialin e nevojshëm ku do bazohet projekti ynë.

Në këtë kapitull do përpiqemi të japim ide se si të arkivojmë të dhënat e mbledhura nga historia gojore dhe si të menaxhojmë koleksionet e historisë gojore.

Koleksionet e historisë gojore kanë marrë një zhvillim të madh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku përdoren gjerësisht nëpër shkolla dhe universitete. Por, dhjetëvjeçarët e fundit ato po përdoren masivisht edhe në vendet evropiane si në Angli apo Gjermani, si një lloj mediumi i ri për të mbledhur informacione me rëndësi për komunitetin, të cilat jo domosdoshmërisht mund të jenë në faqet e gazetave apo portaleve online si lajme të zakonshme, por t'u shërbejnë atyre që kanë interes. Gjithashtu, së fundmi, regjistrimi i dëshmimeve nuk është parë më me skepticizëm nga historianët bashkëkohorë. Shoqata si AHA kryejnë ekspertiza të tilla, si dhe botojnë kritika mbi filma që përmbajnë histori gojore. Këto punime kanë të bëjnë me realizimin e filmave me bazë historike, duke përfshirë elementin e rrëfimit të historisë nga



Biblioteka dixhitale e Kalifornisë, faqja e internetit / <https://www.cdlib.org/>

dëshmitarë të kohës, por edhe publikimin në periodikë të ndryshëm të kritikës së filmit. Imazhet filmike mund ta shprehin në mënyrë më të plotë dimensionin reflektues të historisë gojore, i cili e bën më të qartë rolin njerëzor në krijimin e historisë.

Arkivimi i regjistrimeve

Në Kapitullin 4 kemi përmendur se planifikimi i projektit luan një rol thelbësor në mbarëvajtjen e projektit dhe një element i rëndësishëm është magazinimi, ruajtja e materialeve të projektit. Prandaj, menjëherë pasi keni rënë dakord se ku do të depozitoni materialet e mbledhura duhet të përcaktoni një sistem të mbajtjes së të dhënave dhe të vendosni procedurat e kryerjes së arkivimit. Edhe pse është pjesa më e padukshme e projektit, sistemi i mbajtjes dhe ruajtjes së të dhënave të projektit është shumë i rëndësishëm. Për këtë, ju ndihmon përdorimi i

formave, të cilat ne i kemi përfshirë edhe në Manualin tonë dhe që i gjeni si shembuj të përfshirë në tekst, por edhe në Shtojcën B.

Forma e përshkrimit të projektit na ndihmon, si kemi thënë edhe te pjesa për planifikimin që të kemi një pasqyrë më të qartë se ku duam të arrijmë, cilat janë objektiva, cilat janë burimet dhe koha kur duhet të zbatojmë projektin. Lista e të intervistuarve të mundshëm bëhet pas punës kërkimore nga grupi i projektit që përcakton se kush janë personat që do të mund të intervistohen dhe që lidhen me temën e zgjedhur të projektit. Ndërkohë, forma për të dhënat

Këto forma mund të përfshijnë:

- Forma e propozimit të projektit
- Lista e të intervistuarve të mundshëm
- Forma për të dhënat biografike të të intervistuarve
- Forma e marrëveshjes së mirëkuptimit me të intervistuarin
- Forma me pyetjet e intervistës
- Forma e regjistrimit të projektit
- Forma e ruajtjes së materialeve dhe dokumenteve në arkiva

LISTA E TË INTERVISTUARVE

EMRI	DATA E INTERVISTES	INTERVISTON
B. META	15.03.2018	Ada
A. KUSHI	16.03.2018	Ada
L. NOVI	17.03.2018	Ada
M. ANDONI	18.03.2018	Oni

Lista e të intervistuarve, shembull i plotësuar.

biografike të të intervistuarve ndihmon për të pasur një regjistër të dhënash me emrat, profesionet, kontaktet e të intervistuarve. Këtyre të dhënave mund t'u kthehem herë pas herë gjatë transkriptimit të intervistave, apo kur të kemi nevojë të rikontaktojmë me të intervistuarit, apo edhe në rastet kur duhet të publikojmë të dhënat e mbledhura prej tyre. Si përcaktohet në kapitullin 3, Marrëveshja me të intervistuarin është një formë e rëndësishme, me karakter ligjor, e cila firmoset nga i intervistuari pas çdo interviste. Por, ka raste kur i intervistuari e jep edhe pëlqimin me gojë kur flitet për projekte shkollore.

Në Marrëveshjen e mirëkuptimit duhet të shprehen qartë të drejtat që ka projekti mbi intervistën dhe mënyrat se si do të publikohen të dhënat e mbledhura gjatë projektit. Forma me pyetjet e intervistës ndihmon intervistuesit që të kenë një lloj formati të përcaktuar dhe që lidhet gjerësisht me temën e projektit. Forma e ruajtjes së materialeve/artifakteve dhe dokumenteve në arkiva shërben si një formë inventarizimi, në të cilën përcaktohen materialet, data e ruajtjes, vendi (kuti, dosje) ku janë ruajtur.

Përgatituni që gjatë intervistave, të intervistuarit mund t'u japin materiale shtesë, si: foto, objekte personale dhe sende të tjera. Prandaj, përcaktoni një metodë për të mbledhur dhe për të ruajtur këto sende.

Asnjë regjistrim audio ose video nuk mund të jetojë përgjithmonë dhe në të njëjtën cilësi. Në ditët e sotme, arkivistët mbeten skeptikë për jetëgjatësinë e materialeve të të dhënave dixhitale, projekteve të historisë gojore që përdorin disk apo hardisk dhe që ruajnë pjesën më të madhe të të dhënave të projektit në mënyrë elektronike. Kasetat, disqet, letrat duhen ruajtur në ambiente me një temperaturë konstante dhe larg lagështirës. Mirë është që kasetat të ndërrohen çdo 2-3 vjet në mënyrë që të regjistrimi i bërë me to të mos dëmtohet.

Dëmin që shkakton mosmirëmbajtja e mirë e materialeve zanore dhe filmike, mund ta shohim qartë te regjistrimet e vjetra që transmetohen në televizion ose në internet, qofshin ato edhe të 10-20 vjetëve më parë, ku audio është shumë e dobët dhe dëgjuesi e ka të vështirë të dëgjojë.

Ka shumë mënyra për të ruajtur materialet arkivore. Ju mund të zgjidhni një rend alfabetik apo kronologjik. Edhe një system alfa-numerik mund të jetë lehtësisht i përdorshëm.

Meqënëse ka një sërë dokumentesh të rëndësishme për mbarrëvajtjen e projektit, është mirë që ato të organizohen në dosjet përkatëse: një dosje që përmban materiale që kanë të bëjnë me menaxhimin e projektit; një dosje që përmban intervistat - këto mund të ndahen sipas emrave të të intervistuarve, por mirë do ishte që të ruhej rendi alfabetik, ose rendi kohor, pra, në varësi të kohës kur është kryer intervista. Kontratat mund të ruhen në një dosje të veçantë. Një dosje duhet edhe për materialet e tjera që kanë të bëjnë me drejtimin e projektit, ku mund të ruhen dokumente si p.sh. regjistri i intervistave, korrespondenca, lista e numrave të telefonave, lista e të intervistuarve të mundshëm etj.

Dixhitalizimi i arkivës së historisë gojore

Me zhvillimin e teknologjisë ka ndryshuar jo vetëm forma e paraqitjes, por edhe përmbajtja që emetojmë. **Dixhitalizimi** po merr një hov shumë të madh si një element që ndihmon në përhapjen dhe publikimin e koleksioneve të historisë gojore. Por, siç e kemi cekur edhe më lart, arkivistët janë skeptikë për sa i përket dixhitalizimit të dokumenteve, për faktin se këto dokumente nuk jetojnë përjetë. Ato mbeten përherë të rrezikuara nga defektet teknike. Shto këtu edhe kostot që shoqërojnë procesin, qoftë në momentin e parë të kryerjes së tij, por më shumë në mirëmbajtjen e materialeve.

Gjithashtu, një element tjetër jo pozitiv i dixhitalizimit është fakti se ai ka një përhapje shumë të madhe dhe të gjerë. Për këtë arsye nevojitet të jemi shumë të kujdesshëm gjatë procesimit të informacionit që përmbajnë materialet që ne prezantojmë. Materialet duhet të mos fyejnë e denigrojnë askënd dhe të jenë pro parimeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, publikimi i materialeve vizuale ku pasqyrohen të mitur kërkon një leje të posaçme.

Por, theksojmë se në kohët e sotme, në periudhën e internetit dhe të komunikimit masiv dixhital, dixhitalizimi përbën një domosdoshmëri. Kjo vjen edhe prej faktit se komunikimi bëhet më i shpejtë dhe më i thjeshtë dhe sigurisht, më i gjerë në një periudhë të shkurtër kohore. Një sugjerim do të ishte që dixhitalizimi i koleksioneve të historisë gojore të kryhet duke i bashkangjitur informacione mbi projektin. Këto informacione, siç kemi thënë edhe më lart, përmbajnë të dhëna mbi titullin e projektit, qëllimin e tij, dhe mbi ata që përfitojnë gjerësisht nga ky projekt. Procesimi i intervistave është gjithashtu i rëndësishëm, si dhe publikimi i transkriptimit të tyre pasi është redaktuar më parë nga i intervistuari. Koordinator apo drejtuesi i projektit luan rol në bashkërendimin e informacionit, në mënyrë që produkti final të publikohet duke përmbushur objektivat e projektit.

Publikimi i historisë gojore në forma të ndryshme dhe vlera e saj

Në këtë pjesë të Manualit do të flasim se si të publikojmë të dhënat e mbledhura nga historitë gojore nga klasat e shkollës në faqet e internetit. Gjithashtu, do shohim mënyrat se si mund ta prezantojmë dhe paraqesim historinë gojore.

Shembuj nga shkollat e mesme

Siç u pa edhe më sipër dhe veçanërisht, siç do të trajtohet në kapitullin e ardhshëm, historia gojore përdoret në masë si element didaktik në shkollat e mesme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli, në Gjermani etj. Si mund ta paraqesim historinë gojore, veçanërisht në

shkollat e mesme? Dhe si mund të ndajnë mësuesit e shkollave të mesme dhe nxënësit e shkollës projektet e tyre të historisë gojore me mësuesit, shkollën apo me komunitetin në përgjithësi? Disa ide mund të jenë: t'u kërkohej nxënësve që të shkruajnë një artikull për gazetën e shkollës, të realizojnë një film ose dramë apo të shkruajnë ese reflektuese mbi informacionet e mbledhura. Shembuj të suksesshëm i gjeni më përmbledhjen e mëposhtme.

Artikuj në gazetën e shkollës	Revista "Foxfire": E botuar fillimisht në vitin 1967, Revista "Foxfire" përfshin histori nga traditat e ruajtura dhe ekzistuese të familjeve dhe fqinjëve në rajonin e Appalachia-s Jugore, Shtetet e Bashkuara. Revista u krijua në fillim me historitë e mbledhura nga nxënësit në klasat e anglishtes, në shkollën e mesme "Rabun Gap-Nacoochee", në Xhorxhia. Sot, kjo revistë vazhdon të botohet dy herë në vit nga nxënësit e shkollave të mesme. Ky projekt ka shërbyer si burim frymëzimi kudo për edukimin e historisë gojore. Për më shumë informacion mbi "Foxfire" ose për të blerë revistat e botuara në vite, ju lutem vizitoni: www.foxfire.org .
Filma të shkurtër	Projekti i dokumentarëve në video në shkollën e mesme "Stone Ridge" në Shtetet e Bashkuara, klasa e historisë: Ken Woodward, mësues i historisë në shkollën e mesme i drejtoi nxënësit e klasës së tretë që të transformojnë intervistat e mbledhura me dëshmi të historisë gojore në tre dokumentarë audio, 4-minutësh. Nxënësit e tij mësuuan se si të përdornin programin e editimit të audios "Garage Band" dhe morën instruksione se si të prodhonin pjesë të shkurtra audio, cilat pjesë mund të priten dhe ku të përfshihen skripte të lexuara. Disa nga studentët shfaqën punimet e tyre në YouTube. Për më shumë informacion, ju lutem lexoni reflektimet e Ken Woodward mbi projektin (Woodward 2013). "Pyet Gjyshërit" Konkursi Multimedial: Që nga viti 2016 IDMC i fton nxënësit e shkollave të mesme në gjithë Shqipërinë që të dërgojnë punime të shkurtra audio ose video (deri në 4 minuta) ku të dokumentojnë historitë e brezave më të vjetër mbi periudhën e komunizmit në Shqipëri. Punimet duhet të kombinojnë artin dhe historinë gojore. Ato shfaqen drejtpërdrejt gjatë ceremonisë së dhënies së çmimeve në kryeqytet, në faqen e internetit të organizatorëve, si edhe në YouTube. Për më shumë informacion, ju lutem shihni Rast studimor #1 në kapitullin e mëposhtëm ose vizitoni www.idmc.al/pyetgjysherit-dy.html .

Ese ose postera në klasë

Konkursi “Born in the ‘90s - Explore the Past, Create the Future!”: IDMC u kërkoi të lindurve në fund të viteve 1980 dhe në vitet 1990 të dërgojnë ese, vizatime ose video të shkurtra ku të dokumentohen momentet e tranzicionit në Shqipëri. Pjesëmarrësit duhet të reflektonin mbi dëshmitë e mbledhura nga familjet e tyre, ngjarjet historike që ndodhën në Evropën Lindore rreth viteve 1989-1990. Punët fituese u shfaqën në një ceremoni të veçantë dhe në disa ekspozita pas konkursit. Për më shumë informacion, ju mund të vizitoni www.idmc.al/borninthe90s.html.

Shembuj të tjerë

Mediumi i përhershëm i historisë ka qenë fjala e shkruar - kjo ka qenë mënyra më dominuese e komunikimit dhe prezantimit të historisë. Praktika e historisë, nëse mund ta quajmë kështu, ka filluar me momentin e kalimit nga rrëfimi (orality) te shkrimi i saj. Një tjetër transformim i mëvonshëm i kësaj praktike ka qenë botimi i historisë, i cili e ndryshoi tërësisht atë. Në Shqipëri, kjo është një praktikë e njohur, madje më e njohur se sa dixhitalizimi, publikimi online apo përgatitja e dokumentarëve me temën e historisë gojore. Nga shembujt që kemi përmendur më sipër mund të risjellim projektin “Zërat e kujtesës” të ISKK, i cili në kolanën *Ad memoriam* ka mbledhur në tre volume transkriptet e intervistave të marra nga viktimat e sistemit komunist në Shqipëri. Qëllimi i këtij botimi shprehet edhe në kopertinën e vëllimit III ku shprehimisht thuhet se “[...] përmes përvojave individuale, ku detajet, situatat konkrete, konteksti, personazhet realë të përfshirë në to, e bëjnë jo vetëm të pakontestueshme ekzistencën e krimeve të komunizmit, por, ndihmojnë edhe analizën dhe interpretimin e mënyrës se si funksionoi ai sistem.”

Tjetër shembull për publikimin në libër të dëshmimeve të mbledhura nga historitë gojore është libri *Formësimi i kujtesës kolektive* nga Fabian


Kati, i cili ka bërë një studim antropologjik, historik dhe etnografik mbi krahinën e Malësisë së Madhe, duke marrë shkas nga zhvillimet politike dhe historike që kanë ndodhur në këtë krahinë në vitet 1945-1946. Një përmbledhje tjetër mbresëlënëse e dëshmimeve bazuar në historinë gojore janë vëllimet me titull *Dhimbje*, nga Fatbardha Saraçi (Mulleti), ku ajo ka mbledhur historitë e rrëfyera gojarisht nga gratë që kanë vuajtur dhe janë persekutuar gjatë sistemit komunist. Në parathënien e vëllimit të tretë, autorja shprehet se: “Për të ilustruar këtë genocid shqiptar nga brezi në brez nëpërmjet kujtesës historike, unë përdora artin e të shkruarit për të mos lënë që historia të harrohet. Për mua e rëndësishme ka qenë gjurma historike e të shkruarës” (Mulleti 2014, 6).

Pra shohim se publikimi i veprave të tilla nga autorët mbart në vetvete një mision historik, për të parë se si janë zhvilluar ngjarjet, si i kanë përjetuar njerëzit dhe se sa të rëndësishme janë këto informacione për t’ia transmetuar publikut.

Në këtë kapitull, ne eksploruam arkivin dhe rëndësinë e tij lidhur me intervistat e historisë gojore, të cilat kanë shumë vlerë për ruajtjen e kujtesës në komunitetin lokal, por edhe për kërkuesit e rinj që mund të ndajnë kontributin e tyre me komunitetin. Nëse nuk mundemi të përdorim një arkiv të plotë dixhital si ato që janë listuar në Shtojcën A, ka shumë mënyra të tjera për të publikuar dhe për të ekspozuar rezultatet e projekteve tuaja që variojnë nga botimi i artikujve ose shkrimi në blog, nëse je kërkues i ri dhe deri të publikimi i videove të nxënësve tuaj në YouTube, nëse jeni mësues i shkollës së mesme. Kapitulli tjetër do të eksplorojë më në thellësi se si mësuesit e shkollës së mesme dhe kërkuesit e rinj mund t’i përdorin intervistat e historisë gojore në klasa ose në projekte kërkimore. Lexoni këtë kapitull për t’u frymëzuar nëse planifikoni projektin tuaj të historisë gojore.

Vlerat e historisë gojore në komunitet

Mbledhja e historive me qendër komunitetin i vlen gjithë shoqërisë. Fokusi duhet vënë te ato histori, të cilat janë të prekshme nga të gjithë, dëshmojnë përditshmërinë e jetës sonë dhe na bëjnë më të ndjeshëm nga problematikat që mbartin. Kështu, në projektin "Nonuments 01" një grup i Muzeut të artit tranzitor (Museum of Transitory Art-MoTA), Lubllanë, Slloveni, kanë rikrijuar virtualisht, duke u bazuar në rrëfimet e komunitetit dhe të dëshmitarëve të kohës, një vend monumental në Baltimore, Shtetet e Bashkuara. Ata rikrijuar virtualisht shatërvanin që ishte në mes të qytetit, si një monument që mbart në vetvete histori të rëndësishme dhe të vlefshme për komunitetin. Aplikacioni i realiteti të mbivendosur tregon historitë e aktivistëve, protestat e organizatave të Baltimorës, një propozim martesë dhe të tjera ngjarje lidhur me këtë monument. Për më shumë, vizitoni: <http://nonument01.org/>. Imazhi i mësipërm tregon një nga pamjet filmike nga aplikimi Nonuments dhe është një foto e nxjerrë nga faqja e internetit nonument01.org.



A mund të mendoni mbi mënyrat se si projektet tuaja të historisë gojore mund të jenë të vlefshme për komunitetin lokal?

KAPITULLI 6

MËNYRAT PËR TË PËRFSHIRË HISTORINË GOJORE NË SHKOLLA DHE NË PUNË KËRKIMORE

Mbledhja e dëshmimeve të historisë gojore përmes intervistimit, si metodologji dhe një burim të dhënash historike (Kuhn dhe McLellan 2006), është një traditë kërkimi që filloi të lulëzojë në shekullin e 20-të. Që në vitet 1940, hasim zhvillimin e programeve të historisë gojore në Shtetet e Bashkuara që përqendroheshin, në mënyrë specifike, në përdorimin e metodologjisë në nivelin universitar dhe të shkollës së mesme për të ndërtuar baza të dhënash të historisë gojore që të ishin sa më pranë publikut (p.sh. CCOHR). Sondazhet midis viteve 1974 dhe 2000 e kryera nga AOH, një organizatë e themeluar në SHBA në vitin 1966, tregojnë përdorimin e frytshëm të kësaj metode nga mësimdhënësit, duke filluar nga studentët e diplomuar dhe universitetet në vitet 1970 deri në shkollat e mesme dhe fillore në vitet 1980, për të vazhduar me programe të bashkëpunimit midis universiteteve, shkollave të mesme dhe programet e historisë lokale deri në vitin 2000 (Lanman dhe Wendling 2006). Mësuesit dhe kërkuesit në mbarë botën kanë parë vlerën e brendshme dhe atë publike në integrimin e kësaj metodologjie në praktikën e tyre arsimore.

Ndërsa në Kapitullin 1 e këtij manuali kemi trajtuar tashmë disa nga arsyet kryesore përse intervista e historisë gojore është përhapur si metodologji, por edhe si një praktikë edukative, ky kapitull trajton

mënyrat kreative që mësuesit dhe kërkuesit përfshijnë në punën e tyre. Kapitulli është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë u drejtohet mësuesve të shkollave të mesme dhe fokusohet në përdorimin edukativ të historive gojore në klasë. Ai përfshin mënyra pasive kundrejt atyre aktive për mësuesit dhe nxënësit për të shijuar përfitimet nga intervistat e historisë gojore. Pjesa e fundit u drejtohet kërkuesve dhe hulumtuesve të rinj dhe prek mënyrat e ndryshme që studiuesit kanë përdorur intervistën e historisë gojore, në lidhje me teknikat dhe metodat për të zbuluar njohuri të reja.

Mbani parasysh se ky kapitull paraqet vetëm një skicim të shkurtër të mënyrave ku është përdorur historia gojore. Për më shumë frymëzim, ju lutemi lexoni Shtojcën A që përfshin burime shtesë në internet, apo bazat e të dhënave të historisë gojore që ju mund t'i përdorni për të zhvilluar projektet tuaja.

Grup të rinjsh duke mësuar për ish-burgun dhe kampin e punës së detyruar të Spaçit nga një dëshmitar okular në kuader të konkursit "Pyet Gjyshërit" 2017. © IDMC.



Si të motivojmë nxënësit e shkollave të mesme që të zhvillojnë projekte të historisë gojore

"Ishte kur kuptova se po ndihmoja në ruajtjen e këtyre rrëfimeve të një brezi që po vdiste, që më frymëzoi të bëhesha intervistuesi më efektiv i mundshëm". (Përgjigja e nxënësit ndaj një projekti të historisë gojore, Zieren 2011, 168)

Përtej zhvillimit të përmbajtjes së re të lëndëve, mësuesit e shkollave të mesme i kanë përdorur projektet e historisë gojore që nga fundi i shekullit të 20-të, për të motivuar studentët e tyre për të përmbushur një sërë objektivash arsimore, nga zhvillimi i aftësive të tilla si të shkruarit dhe komunikimi, deri te nevoja për të përfituar një sens vlerësimi për këto subjekte (Lanman dhe Wendling 2006, Kuhn dhe McLellan 2006, Stein dhe Scatena 2006, Boyd, Fernheimer dhe Dixon 2015, mes shumë të tjerëve). Gjithashtu, mësuesit kanë përdorur projekte të historisë gojore për të provokuar studentët që të diskutojnë mbi tema të sikletshme nga e kaluara, si p.sh. tema e racizmit në Shtetet e Bashkuara (Johnson dhe Mason 2017), ose të përfytyrojnë se si mund të ketë qenë jeta në një periudhë të caktuar historike (Tobbell 2016, 128). Pa harruar se projektet e historisë gojore janë përdorur edhe për të trajtuar se si e tashmja është e lidhur me të kaluarën, p.sh. se si ndërlidhja midis racës, gjinisë dhe shtresës sociale vazhdon t'i ndikojë njerëzit në mënyra të ndryshme (Johnson dhe Mason 2017, 287). Dhe në fund, është elementi njerëzor që transmetohet në historitë gojore, shumëllojshmëria e mënyrave se si është përjetuar historia – ajo çfarë ka frymëzuar mësuesit për të gjetur mënyra kreative për të motivuar nxënësit e tyre.


Sipas Lanman dhe Wendling (2006), projektet e edukimit bazuar në historinë gojore zakonisht përdorin një nga dy qasjet: përdorimi pasiv i historisë gojore ose krijimi dhe grumbullimi aktiv i saj. Qasjet pasive

i japin prioritet përdorimit dhe analizës së të dhënave të gatshme të historisë gojore. Ndërsa, qasjet aktive kërkojnë që studentët të veshin petkun e studiuesit, të marrin pjesë personalisht në procesin e hulumtimit, intervistimit, analizimit, interpretimit, zhvillimit të narratives dhe prodhimit të produkteve konkrete (Lanman dhe Wendling 2006, Tobbell 2016, 128). Megjithatë, termi “pasiv” nuk nënkupton se kjo qasje është më pak eksperimentale se ajo aktive. Përkundrazi, qasjet pasive për dëshmitë e historisë gojore mund të jenë po aq produktive për të arritur objektivat e lartpërmendura, siç është përfytyrimi i jetës në një epokë tjetër historike. Ato gjithashtu vlejné për mbledhjen e njohurive të reja nga arkivat ekzistuese dhe përmirësojnë perceptimin e publikut për këto arkiva.

Para se të prezantojmë disa shembuj të rasteve studimore të suksesshme që përfshijnë të dy qasjet, po ju njohim me një model bazë që mund të ndiqni për përfshirjen e intervistës së historisë gojore në shkollë. Ai bazohet përgjithësisht mbi modelin e “historisë gojore në arsim” të Barry Lanman (2006) dhe të modeleve të tjera të suksesshme të përdorura nga niveli i shkollës së mesme dhe deri në universitet. Ky model mund të zgjerohet lehtësisht dhe të përshtatet për përdorim në shkollën tuaj. Më poshtë, ne kemi paraqitur të gjithë hapat dhe kemi përfshirë një përshkrim të shkurtër për t’ju ndihmuar dhe për t’ju udhëhequr përmes këtij procesi.

1. IDENTIFIKONI një temë gjatë përcaktimit të objektivave tuaj kryesorë

Nëse shihni listën e arkivave të historisë gojore në internet, të cilën mund ta gjeni në Shtojcën B, do të vini re se disa prej tyre janë të organizuara rreth një teme qendrore, p.sh. programi Southern Oral History në Universitetin e Karolinës së Veriut trajton dëshminë e njerëzve që kanë jetuar në pjesën jugore/juglindore të SHBA. Në një kontekst më të ngushtë, mësuesit përdorin shpesh të njëjtën qasje kur



Katër hapat për të hartuar dhe zbatuar një aktivitet duke përdorur historine gojore në klasë. Grafikë nga Jonathan Eaton.

hartojnë projekte të praktike të historisë gojore për nxënësit e tyre. Për shembull, në vitin 1966, Eliot Wiggenton nisi një nga projektet më të suksesshme dhe më të njohura të historisë në shkollën e mesme të quajtur “Foxfire” kur u kërkoj nxënësve të regjistrojnë trashëgiminë e komuniteteve që jetojnë në Appalachians (Foxfire 2006). Duke kufizuar qëllimin e projektit në trashëgiminë e gjallë të komuniteteve Appalachian, Wiggenton ka zgjeruar njohuritë tona mbi Appalachians-ët përmes dëshmive të pasura që zbuluan dhe rrëfyan nxënësit e tij.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të identifikoni objektivat, të cilat doni t’i arrini që nga fillimi i projektit tuaj të historisë gojore, pasi kjo do të përcaktojë formën përfundimtare të tij. Për shembull, Johnson dhe Mason (2017) dëshironin që nxënësit e tyre të diskutonin mbi temën e racave në SHBA. Për të përmbushur këtë objektiv, ata u kërkuar nxënësve të intervistonin një subjekt të vetë-përzgjedhur mbi Lëvizjen për të Drejtat Civile në Shtetet e Bashkuara dhe më pas ta paraqesin

historinë e të intervistuarit në klasë. Në këtë rast, intervista e historisë gojore është përdorur si një objektivi, përmes të cilit studentët mund të fillojnë të përfshihen në diskutim, pasi shumë prej tyre mendonin se ishte më e lehtë për të folur mbi përvojën historike të dikujt tjetër për temën e përzgjedhur (Johnson dhe Mason 2017).

2. PLANIFIKONI formatin e detyrës së historisë gojore. Kini parasysh ta mbani sa më të menaxhueshëm

Tani që keni identifikuar një temë së bashku me objektivat tuaj kryesore dhe keni lexuar mjaftueshëm informacione të dobishme për kryerjen e intervistave të historisë gojore (Shih kapitujt 3 dhe 4, ky Manual), është koha të shqyrtojmë se çfarë formati do të marrë projekti juaj. Për këtë, ju duhet të konsideroni disa nga pyetjet e mëposhtme. Sa kohë i nevojitet klasës sime ta përfundojë këtë projekt? A zgjat vetëm një ditë apo gjatë gjithë vitit shkollor? Cilat pajisje dhe/ose burime kam në dispozicion për këtë projekt? A ka ndonjë organizatë komunitare, me të cilën mund të bëhemi partnerë, si një bibliotekë lokale apo organizatë joqeveritare? A duhet të përdor një qasje pasive apo aktive në trajtimin e historisë gojore? A ka një produkt të veçantë që unë do të doja të prodhonte klasa ime si p.sh. një manual për historinë gojore apo burime interneti për shkollën? Si do ta vlerësoj në fund këtë detyrë?

3. ZBATONI hapat e mbledhjes së historisë gojore

Pasi të keni një plan të përcaktuar dhe të keni shfrytëzuar të gjitha burimet dhe të jeni pajisur me lejen për të kryer projektin, zbatoni hapat e intervistimit për mbledhjen e historive gojore. Për shembull, disa hapa për një ushtrim më aktiv mund të përfshijnë hulumtimin e temës, përzgjedhjen e mëvetësishme të subjektit të intervistës dhe marrjen e pëlqimit paraprak nga ana e të intervistuarit, zhvillimin e pyetjeve të intervistës, kryerjen e intervistës, përshkrimin e saj, dhe paraqitjen e një versioni të shkurtuar të intervistës në klasë (Lanman 2006).

4. VLERËSONI punimin tuaj dhe shihni se çfarë mund të përmirësoni herën tjetër

Vlerësimi juaj duhet të shkojë përtej një vlerësimi të thjeshtë të produktit përfundimtar, qoftë ky transkript i shkruar, një prezantim ose një artikull reviste. Kërkojuni nxënësve tuaj të reflektojnë vetë procesin. Si e kanë përjetuar këtë përvojë? Çfarë mësuan nxënësit nga kjo përvojë? Si mund ta përmirësoni këtë detyrë për herën tjetër? Së fundmi, mos harroni të rishikoni objektivat tuaj fillestarë. A e provon analiza vetëreflektuese e nxënësit dhe/ose produkti përfundimtar se i keni përmbushur objektivat tuaja fillestare? Për shembull, nëse synimi juaj ishte të kërkonit nga nxënësit që të diskutojnë mbi çështjet e ballafaqimit me të shkuarën komuniste, a e mundësoi qëllimin projekti që realizuat?

RAST STUDIMOR 1

“Pyet Gjyshërit” (Shembull i një qasjeje aktive të edukimit përmes historisë gojore)

Që nga viti 2015, Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC), një organizatë joqeveritare lokale në Shqipëri, organizon një konkurs të historisë gojore për nxënësit e shkollave të mesme të quajtura “Pyet Gjyshërit”. Ky konkurs inkurajon të rinjtë të intervistojnë anëtarë të gjeneratave që kanë jetuar gjatë regjimit komunist të Shqipërisë, si gjyshërit apo fqinjët e tyre, për të mësuar rreth të kaluarës së afërt të vendit dhe për të reflektuar mbi një periudhë që ishte “emblematisht për zhvillimin e vendit të tyre” (“Pyet Gjyshërit” www.idmc.al). Më poshtë, ne shohim se si faza e dytë e këtij projekti “Pyet Gjyshërit 2” përmban secilin nga katër hapat e paraqitur më parë. Për të mësuar më shumë rreth këtij projekti, vizitoni faqen e internetit “Pyet Gjyshërit 2” në adresën www.idmc.al.



Broshurat dhe posterat e prodhuar nga IDMC për të shpallur konkursin e tyre vjetor "Pyet Gjyshërit" 2016, 2017, 2018.

1. IDENTIFIKIMI

Projekti "Pyet Gjyshërit" fokusohet në veçanti në dëshminë personale të individëve që kanë jetuar gjatë periudhës komuniste të Shqipërisë. Objektivi kryesor është që të rinjtë të mësojnë për një të kaluar të afërt, e cila ka ndikuar në zhvillimin e vendit të tyre deri më sot. Për konkursin e vitit 2017, IDMC u kërkoi studentëve të përqendroheshin te dëshmi, të cilat bazoheshin specifikisht mbi objekte nga periudha e komunizmit ose që kishin lidhje me tregime të jetës së përditshme.

2. PLANIFIKIMI

Për këtë projekt, IDMC zgjodhi një format konkursi për nxënësit e shkollave të mesme nga 15 në 19 vjeç. Nxënësit mund të punonin vetëm ose në grupe, për të krijuar një klip multimedial (audio ose video deri në katër minuta) që trajtonte temën kryesore. Studentët kishin 6 javë kohë për të dorëzuar një punim. Për të ndihmuar studentët në procesin e zbatimit, organizatorët hartuan kriteret specifike për konkursin, p.sh. prezantimet duhet të ishin në gjuhën angleze ose shqip.

3. ZBATIMI

Shumë nga prezantimet prezantonin punën e katër deri pesë nxënësve që kishin punuar së bashku në klasat e historisë të shkollës së mesme për të hartuar këtë prezantim. Studentët hulumtuan mbi temën specifike që donin të paraqitnin. Ata kryen intervista me anëtarët e familjes dhe anëtarët e komunitetit të tyre. Disa nga grupet fituese pastaj punuan së bashku për të bërë skenarin dhe krijuan një film të shkurtër, i cili përfshinte shkrimin e tekstit, duke caktuar role për filmin, filmimin, redaktimin dhe proceset e tjera të postproduksionit, si shtimi i klipeve audio dhe atyre zanore.

4. VLERËSIMI

Të gjitha punimet u vlerësuan nga një juri e pavarur ekspertësh dhe figurash publike. Vlerësimi pati kriteret specifike, të tilla si kuptueshmëria e produktit, risia dhe aftësia artistike për të unifikuar formën me përmbajtjen. Gjatë tre viteve të fundit, IDMC ka pasur kohë të mjaftueshme për të vlerësuar së brendshmi konkursin e historisë gojore, për të vlerësuar nëse këto konkurse i përmbushën objektivat e tyre fillestare dhe për ta përmirësuar atë për vitin e ardhshëm. Për shembull, nëse vizitoni faqen e tyre, do të vini re se aktiviteti ka evoluar nga një konkurs i eseve në një konkurs multimedial.


Për ta reklamuar këtë projekt, IDMC ka shpallur një thirrje në faqen e saj të internetit dhe në rrjetet e saj sociale si Facebook, Twitter apo Instagram, ka krijuar fletëpalosje dhe ka vizituar shumë shkolla të mesme në të gjithë Shqipërinë duke i ftuar nxënësit që të marrin pjesë aktive. Projektet e historisë gojore janë mundësi shumë të mira për bashkëpunim mes shkollave dhe organizatave vendore të komunitetit.

RAST STUDIMOR 2

"Kompozimi i historisë me një Indeks" (Shembull i një qasjeje pasive në edukimin e historisë gojore)

Indeksi është praktika e caktimit të përshkrimeve të shkurtra në dokumente me shumë informacione, si transkriptet, për të vlerësuar ose shqyrtuar më lehtë atë material gjatë fazave të mëvonshme ose pas përfundimit të projektit. (Shikoni foton e mëposhtme për një shembull.)

Rasti ynë studimor është marrë nga një projekt bashkëpunimi mes Douglas Boyd, drejtor i "The Louis B. Nunn Center for Oral History" dhe Janice Fernheimer, profesore e shkrimit, retorikës dhe studimeve digjitale në Universitetin e Kentucky. Studentëve iu kërkua të indeksnin



Kjo foto tregon indeksin e librit të Elidor Mëhillit, *Nga Stalini te Mao: Shqipëria dhe Bota Socialiste* që ishte e botuar në vitin 2017. © Kailey Rocker.

arkivin në internet për projektin "Histori gojore të bashkësisë hebraike të Lexingtonit." Për më shumë informacion të detajuar në lidhje me këtë shembull, ju lutemi lexoni artikullin origjinal i botuar në 2015 "Indexing as Engaging Oral History Research: Using OHMS to "Compose History" in the Writing Classroom" nga autorët Douglas Boyd, Janice Fernheimer, dhe Rachel Dixon.

1. IDENTIFIKIMI

Qëllimi i këtij ushtrimi nga Boyd, Fernheimer dhe Dixon ishte të ndihmonte studentët që kishin interes të shkruanin dhe të reflektonin në mënyrë të vetëdijshme mbi procesin e të shkruarit. Përveç kësaj, ekipi i punës dëshironte që studentët të kuptonin se si mund të shkruanin për një audiencë të caktuar dhe të analizonin efektet që puna e tyre mund të kishte jashtë klasës.

2. PLANIFIKIMI

Boyd dhe Fernheimer projektuan dy kurse semestrale që u përqëndruan në shkrimin, si dhe leximin e dëshmimeve lokale të historisë gojore në Lexington, Kentucky, SHBA. Studentëve iu kërkua të dëgjonin dhe të analizonin nga ana retorike një intervistë të historisë gojore, të përdornin një aplikacion të dizajnuar për ta arkivuar dhe indeksuar atë intervistë, dhe së fundmi, të punonin me studentë të tjerë me intervista të së njëjtës temë për t'i kontekstualizuar ato përmes një produksioni të shkurtër në audio që do të transmetohej para publikut.

3. ZBATIMI

Për procesin e indeksimit, studentët e Fernheimer dëgjuan intervista të plota, të gjata deri në një orë e njëzet minuta. Pastaj zgjedhën një numër fjalësh ose titujsh të shkurtër për të përshkruar çdo intervistë. Puna ishte sfiduese, pasi materiali duhej kthyer në një kontekst më të gjerë, në mënyrë që dikush të mund t'i përdorte këto të dhëna të historive gojore në të ardhmen.

4. VLERËSIMI

Përveç produkteve përfundimtare - intervistat e indeksuara dhe produksionet në audio - u kërkua nga studentët të shkruanin ese reflektuese, duke diskutuar përvojën e tyre gjatë gjithë këtij procesi. Nga përgjigjet e studentëve, Fernheimer dhe Boyd ishin në gjendje të vlerësonin se **indeksimi** u kërkoi studentëve që të angazhoheshin në mënyrë kritike me materialin dhe të konsideronin me kujdes audiencat publike që mund ta përdorin këtë arkiv të historisë gojore në të ardhmen.



Foto e kryer nga IDMC-ja gjatë intervistës së historisë gojore për projektin "Unë Dëshmoj." © IDMC.

Krijimi i njohurive të reja - Përdorimi i historisë gojore në kërkimin tuaj

Zakonisht, historia gojore përdoret për qëllime të ndryshme nga studiuesit e shkencave shoqërore dhe atyre humane. Dhe sikurse mësuam më sipër, përdorimi i historisë gojore në kërkime studimore është shumë i varur nga objektivi origjinal dhe tema specifike e studiuesit. Më poshtë mund të lexoni disa shembuj se si hulumtuesit kanë përdorur intervista dhe bazën e të dhënave të historisë gojore për të mësuar rreth jetës së përditshme, për të kuptuar më mirë identitetin kolektiv dhe kujtesën, për të frymëzuar forma të reja të analizës së të dhënave dhe për të reflektuar mbi pozicionin dhe efektin e roleve specifike në procesin e intervistës.

1. Jeta e përditshme dhe përvoja individuale

Kamla kishte marrë mjaftueshëm pikë në provimet përfundimtare për të siguruar një vend në kolegjin bujqësor, për të cilin e kishte përgatitur shkolla e saj. Ajo nuk kishte interes të veçantë për bujqësinë dhe kishte shkuar në këtë shkollë vetëm sepse gjimnazi ishte në anën tjetër të qytetit. Xhaxhallarët e saj i kishin thënë asaj të zgjidhte: ose ta linte fare shkollën ose të shkonte në shkollën bujqësore aty pranë. Por ajo e donte shkollën dhe nuk mund ta linte. (Kamla, ekstrakti nga Abu-Lughod 2008, 208)

Shumë antropologë, sociologë, historianë, shkrimtarë, ndër të tjera, e përfshijnë teknikën e historisë gojore brenda projekteve të tyre kërkimore, veçanërisht për shkak të përvojave individuale që përfshihen aty. Pjesa e mësipërme është shkëputur nga një etnografi e titulluar *Writing Women's Worlds (Shkrimet e Botës së Grave)* nga antropologia Lila Abu-Lughod. Abu-Lughod përfshin teknikën e intervistës së historisë gojore, ndër të tjera, siç është vëzhgimi i pjesëmarrësve, për të mbledhur dëshmitë e grave të ndryshme Beduine, disa prej tyre aq të reja sa Kamla gjimnaziste (2008). Nëpërmjet këtyre dëshmimeve dhe duke



Përmes historisë gojore mund të mësojmë më shumë për përvojat e individit. © IDMC.

2. Historia gojore në shërbim të identitetit dhe kujtesës kolektive

Përveç evidentimit të individuale ose të veçantës, teknikat dhe të dhënat e historisë gojore mund të përdoren për të kuptuar praktika organizative të korporatave dhe grupimeve të ndryshme, si dhe procesin e krijimit të kulturës në përgjithësi. Janis Thiessen përdor metodologjinë e historisë gojore për të treguar dhe për të vlerësuar mitet dhe narrativat kyçe për kulturën organizative të korporatave të ndryshme në Kanada (2014). Përmes dëshmisë gojore, ajo ishte në gjendje të vlerësonte mitet që ekzistojnë në zyra dhe sa të rëndësishme ishin ato për punonjësit apo drejtuesit e kompanisë, në momente të ndryshme brenda historisë së organizatës. Për shembull, në WT Hawkins në Kanada (krijuesit e

krijuar një **marrëdhënie** të mirë me gratë, Abu-Lughod ishte në gjendje të vëzhgonte jetën e përditshme të tyre dhe të shkruante në mënyrë më të diferencuar sesa përgjithësimet kulturore etnografike të përhapura në Lindjen e Mesme (2008, xii). Në fund të fundit, një nga objektivat kryesorë të këtij manuali është të tregojë se si historitë personale mund të sfidojnë përkufizimet klishe për kultura, vende dhe persona të ndryshëm.

Cheezies), ajo zbuloi përmes historive gojore se kultura e kompanisë u kushtonte më shumë rëndësi aspekteve si nacionalizmi, familja dhe veçantisë së produktit të tyre, kundrejt produkteve të kompanive të tjera që theksonin fenë. Ky studim e ndihmoi Thiessen të tregonte një lidhje midis kulturave të këtyre bizneseve dhe proceseve më të gjera sociale, si nacionalizmi (2014, 61, 70).

3. Të frymëzojë forma të reja të analizës së të dhënave - Analiza dytësore

Disa studiues vendosin të kthehen sërish te arkivat e vjetra për të parë përmbajtjen e intervistës në një dritë të re ose për të krijuar metoda dhe mënyra të reja të interpretimit të të dhënave. Sharon Webb et al. përdori Archive of Resistance Testimony nga Universiteti i Sussex për të rianalizuar drejtpërdrejt regjistrimet audio të historisë gojore (2017). Megjithë përfitimet nga përdorimi i mjeteve dhe metodave dixhitale, përsëri analiza e historive gojore fokusohet kryesisht në transkriptet e shkruara, që janë potencialisht problematike për shkak të natyrës interpretuese të transkriptimit. Në një projekt p.sh., autorët përdorën

Përmes historisë gojore mund të mësojmë për përvojën kolektive. © IDMC.
Lexoni më shumë në seksionin 2 në faqen 68.



metodat e rikthimit të informacionit muzikor për të rivlerësuar gjurmët audio në intervistat e kryera dhe zbuluan dinamika më të hollësishme të fshehura “nën fjalët” e regjistruara nga intervistuesi (Webb et al. 2017).

4. Për të reflektuar mbi pozicionimin - Analiza dytësore

Studiuesit si Jakub Mlynar kanë përdorur teknika të tjera analitike të mesme, të tilla si analiza e mesme mikro-sociologjike për të shqyrtuar arkivat e vjetra (2016). Mlynar rishqyrtoi The Visual History Archive of Shoah Foundation të University of Southern California-së, i cili përmbante intervista me dëshmitarë të Holokaustit dhe genocideve të tjera, për të vlerësuar rolin dhe ndikimin e intervistuesit, pasi shumica e koleksioneve të historisë gojore përqendrohen tek transmetuesi. Në analizën e tij, Mlynar vuri re që të dy, si intervistuesit dhe të intervistuarit patën ndikim në rezultatin e asaj që thuhej dhe regjistrohej. Intervistuesit, në mënyrë tipike e udhëhiqnin temën duke kufizuar kështu qëllimin e asaj që u diskutua dhe të intervistuarit shpesh kishin presupozime rreth faktit se çfarë ishte historia gojore dhe çfarë duhet të regjistrohet.

Mlynar na rikujton se shumë baza të dhënash janë krijuar tashmë përmes projekteve të historisë gojore “të orientuara drejt procesit” (2016). Prandaj, ekzistojnë shumë baza të dhënash dhe arkiva të disponueshme për analiza dytësore. Sidoqoftë, intervistat e historisë gojore zhvillohen ndërmjet intervistuesit dhe të intervistuarit në një kohë dhe në një vend të caktuar. Kjo duhet patur parasysh para se të fillohen projektet e historisë gojore.

Tani që keni mësuar më shumë mbi intervistat e historisë gojore dhe vlerat e tyre për kërkuesit e rinj dhe nxënësit e shkollave të mesme, shpresojmë të gjeni mënyrat për t'i integruar ato në aktivitetet shkollore dhe në projektet kërkimore.

A ju vijnë në mendje shembuj të tjerë se si mund t'i përdorni intervistat e historisë gojore në kërkimet tuaja?

SHTOJCA A

BURIME TË TJERA PËR HISTORINË GOJORE NGA INTERNETI

Më poshtë, do të gjeni një listë jo gjithëpërfshirëse të burimeve në internet, të cilat përmbajnë informacione shtesë dhe udhëzime mbi kryerjen, depozitimin dhe shpërndarjen e intervistave të historisë gojore. Shumë nga këto faqe interneti përfshijnë edhe arkiva dixhitalë të publikuar, të cilët mund të jenë një burim shumë i mirë frymëzimi për projekte kërkimore dhe planifikimin e ushtrimeve aktive të historisë në shkolla. Arkivat në internet mund të përdoren për të eksploruar qasjet pasive të punës me historinë gojore në shkolla (shih Kapitulli 6 i këtij Manuali).

Lista e mëposhtme ndahet në 2 seksione: Bazat e të dhënave të historisë gojore dhe burimet brenda Shqipërisë dhe burime nga vende të tjera. Secili burim ka një përshkrim të shkurtër për t'ju ndihmuar të vendosni se cili është më i përshtatshëm dhe më i dobishëm për ju. Për më tepër, disa nga titujt përdorin simbolin “>”. Ky simbol tregon rrugën e linqeve të nevojshëm për të gjetur materiale të historisë gojore në të nga faqja kryesore në internet.

BURIME NGA SHQIPËRIA

Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) > Observatori i Kujtesës > Unë Dëshmoj

Në vitin 2017, IDMC filloi projektin e historisë gojore për të mbledhur dëshmi të personave të persekutuar gjatë regjimit komunist në Shqipëri (1944-1990). Faqja e internetit përmban histori gojore tematike, rajonale dhe bazuar mbi ngjarje të caktuara në formën e video klipëve të nxjerra nga intervistat. Kush është i interesuar të njohë të gjithë intervistën, pa shkurtime, duhet të paraqesë një kërkesë, e cila mund të bëhet nëpërmjet një forme të publikuar në fund të faqes.

<http://www.observatorikujteses.al/une-deshmoj/>

Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) > Evente > Pyet Gjyshërit > Pyet Gjyshërit 1, 2 & 3

Që prej vitit 2015, IDMC organizon dhe sponsorizon një konkurs të historisë gojore që zhvillohet për nxënësit e shkollave të mesme në Shqipëri. Ky konkurs i historisë gojore fokusohet, veçanërisht, mbi memorien dhe eksperiencën gjatë periudhës së regjimit komunist në Shqipëri, duke frymëzuar një dialog mes brezave - mes të rinjve të lindur pas periudhës komuniste dhe familjarëve më të vjetër. Shihni këtë faqe nëse dëshironi të mësoni më shumë për konkursin dhe për rezultatet që ka pasur në vitet e kaluara, punimet e të cilit kanë ardhur në formën e videove të shkurtra, eseve dhe vizatimeve (shih Kapitullin 6 të këtij Manuali, për raste studimore që shqyrtojnë "Pyet gjyshërit 2").

<https://www.idmc.al/pyetgjysherit.html>

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) > Projektet > Zërat e Kujtesës > Projekti, Dëshmitë në formë video - regjistrimet

Prej vitit 2016, ISKK në bashkëpunim me partnerë të tjerë ka përdorur videot për të regjistruar dëshmitë e personave që kanë qenë dëshmitarë

të krimeve kryer në periudhën komuniste në Shqipëri. Shumë prej historive gojore janë transkriptuar dhe botuar në formën e librave; të tjera dëshmi janë mbledhur dhe do të botohen së shpejti në faqen e tyre të internetit në dosjen "Dëshmitë në formë video - regjistrimet" tab.

http://www.iskk.gov.al/?page_id=1375

Kujto.al > Dëshmi

Prej vitit 2018, fondacioni jo-fitimprurës "Kujto", punon për të kompozuar një arkiv në internet për të mbledhur memorien kolektive të periudhës së komunizmit në Shqipëri (1945-1991). Platforma e internetit është interaktive. Përmban një ndërthurje të materialeve të prodhuara më parë (të tilla si "Zërat e kujtesës", si dhe intervista dhe materiale të mbledhura rishtazi nga persona që duan të ndajnë dëshmitë historike personale ose të familjeve të tyre.

<https://kujto.al/kategoria/deshmi/>

BURIME NGA VENDE TË TJERA

The Oral History Society (OHS)

Themeluar në vitet 1970, ky grup i historisë gojore, i vendosur në Mbretërinë e Bashkuar ka punuar të zhvillojë fushën e historisë gojore në Britani dhe në të gjithë globin. Përveç organizimit të konferencave vjetore mbi historinë gojore dhe publikimit të një gazete mbi këtë fushë, OHS ofron trajnime dhe këshilla mbi zhvillimin e intervistave të historisë gojore, si dhe linqe në arkivat dhe koleksionet në internet.

<http://www.ohs.org.uk/>

The American Historical Association (AHA)

E ngritur në vitet 1880, kjo shoqëri e historianëve, e vendosur në Shtetet e Bashkuara, ka mbështetur edukimin e historisë, si dhe rëndësinë e vlerësimit kritik të historiografisë. Kjo shoqatë ka prodhuar një numër

të konsiderueshëm burimesh për sa i përket punës me historinë gojore, veçanërisht, në lidhje me bordet e rishikimit të etikës. AHA, gjithashtu, përmban linqe për të bërë thirrje për pjesëmarrje në seminare mbi historinë gojore dhe burime të tjera shtesë.

<https://www.historians.org/>

The Columbia Center for Oral History Research (CCOHR)

CCOHR ndodhet në Universitetin e Columbias, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe është themeluar në vitin 1948. Është një nga institucionet kryesore si për praktikën e intervistave të historisë gojore ashtu edhe për mësimdhënien (ofron edhe një program Master për kërkimin në historinë gojore). Faqja e tyre e internetit ofron udhëzime për të shkruar transkriptet e historisë gojore, si dhe burime të tjera shtesë, përfshirë edhe një listë të gjerë të literaturës lidhur me këtë fushë. Për më tepër, në dosjen e faqes së tyre të internetit "completed works", ju mund gjeni projekte të mëparshme zhvilluar prej tyre dhe arkivat që ata kanë.

<http://www.ccohr.incite.columbia.edu/>

The Southern Oral History Program (SOHP)

Prej vitit 1973, SOHP ka përdorur metodën e intervistave të historisë gojore mbi të kaluarën e jugorëve në Shtetet e Bashkuara. Faqja e tyre e internetit ofron një koleksion të madh (që vazhdon të rritet) të historive gojore- regjistrimit dhe transkripteve- përveç shumë burimeve se si të kryejmë këto lloj intervistash. Ata ofrojnë materiale mësimore për mësuesit nga shkolla fillore deri në atë të mesme.

<https://sohp.org/>

Foxfire

Revista "Foxfire", e cila do të rritej më vonë kombëtarisht si një organizatë e njohur për ruajtjen e trashëgimisë, filloi në vitin 1966 në klasën e anglishtes në shkollën e mesme të Appalachia-s Jugore në Shtetet e Bashkuara. Kjo është një nga të parat shembuj të suksesshëm

të përdorimit aktiv të historisë gojore në klasa. faqja e tyre e internetit ofron një numër kursesh dhe materialesh, disa prej të cilave mund t'i marrësh pa pagesë, nëse regjistrohesh.

<https://www.foxfire.org/>

Louie B. Nunn Center for Oral History

Louie B. Nunn Center for Oral History ndodhet në Universitetin e Kentakit. Faqja e internetit e Qendrës përfshin një përmbledhje të bazave të të dhënave arkivore të historisë gojore, të organizuara sipas subjektit dhe fushave tematike. Shumë prej arkivave të historisë gojore, përfshijnë intervista të plota, të cilat janë të indeksuara, në mënyrë që dëgjuesit të mund të gjejnë sa më lehtë histori gojore, që lidhen me fushën e tyre të interesit. Për më tepër, të interesuarit mund të kërkojnë akses në kopje të intervistave.

<https://kentuckyoralhistory.org/>

The Mass-Observation Archive

Një prej koleksioneve më të mëdhaja të historisë gojore gjendet në Universitetin e Sussex-it, arkivi i të cilit përshin dokumente dhe pamje që nga lëvizja e "Mass Observation". Ky koleksion ka si prioritet rëndësinë e regjistrimit të jetës së përditshme në Britani nga viti 1937 deri në vitet 1950. Ju mund të vizitoni ose të shqyrtoni burimet arkivore vetëm pas regjistrimit.

<https://www.amdigital.co.uk/primary-sources/mass-observation-online>

The Visual History Archive

Visual History Archive gjendet në Fondacionin Shoah, të Universitetit të Kalifornisë së Jugut, i cili është një institucion për historinë vizuale dhe edukimin. Filloi si një depo për dëshmitë e të mbijetuarve të holokaustit dhe që prej asaj kohe është zgjeruar duke përfshirë edhe dëshmi të tjera mbijetese nga ngjarjet që lidhen me gjenocidin, përfshirë edhe gjenocidin në Armeni, Masakrën e Nanjing-ut, Gjenocidin kundër

tutsëve në Ruanda dhe gjenocidin në Guatemalë. Regjistrohuni pa pagesë dhe mund të shqyrtoni koleksionet e tyre me më shumë se 55,000 dëshmi video.

<https://sfi.usc.edu/vha>

StoryCorps

StoryCorps është krijuar në vitin 2003 në New York, SHBA dhe është një shërbim publik që prezanton të gjithë njerëzit në Shtetet e Bashkuara me mundësinë për të regjistruar dhe për të ndarë historitë e tyre në përpjekje për "të krijuar një botë më të drejtë dhe më të ndjeshme"- sipas faqes së tyre të internetit. Me ndihmën e pajisjeve të regjistrimit, njerëzit kanë një mundësi unike për të regjistruar dhe për të arkivuar biseda kuptimplota me dikë tjetër. Vizitoni faqen e tyre në internet që të dëgjoni këto histori

<https://storycorps.org/>

SHTOJCA B

MATERIALET PËR TË REALIZUAR NJË PROJEKT TË HISTORISË GOJORE

Projekt propozim

Titulli i projektit: Data e fillimit: Data e përfundimit: Shpenzimet financiare (në lekë): pa pagesë	Drejtues i projektit/ Institucioni
Qëllimi i projektit: (1 rresht)	
Përshkrimi dhe arsyet pse nevojitet një projekt i tillë: (15 rreshta maks.)	
Aktivitetet e projektit (10 rreshta maks.) Aktiviteti 1- Aktiviteti 2- Aktiviteti 3- Aktiviteti 4-	

Buxheti i detajuar (Lek)

Përshkrimi i kostove që nevojiten për aktivitetet (shembull)	ALL
Pagesa për koordinatorin 1 koordinator x ... Lek (ALL)	
Pagesa për intervistuesit 3 intervistues x ... Lek (ALL)	
Qiraja për pajisjet e intervistimit	

(buxheti duhet të përfshijë çdo detaj që parashikohet te aktivitetet, p.sh. kosto për stafin, pajisjet e regjistrimit, qiraja e sallës ku do kryen intervistat, kostot e udhëtimit etj.)

Kohëzgjatja e projektit

	Muajt											
Titulli	Jan	Shk	Mar	Pr	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Puna përgatitore												
Intervistat												
Transkriptimi												
Përpunimi												

Miratuar nga Drejtoria e shkollës _____ data _____

Forma për Regjistrin e projektit

Arkivuar						
Artifakte /foto/ referencia						
Përpunimi i të dhënave (i kryer prej kujt)						
Draft transkriptimi për narratorin						
Kontrata e nënshkruar (si shënim)						
Data e intervistës						
Intervistuesi						
Intervistuesi						

Regjistri për arkivin

Nr.	Titulli i dokumentit	Lloji i dokumentit	Emri personit	Data e dokumentit	Data e arkivimit	Vendi në arkiv
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Unë,, jap pëlqimin dhe pajtohem me publikimin e intervistës dhe përdorimin e saj të pakufizuar dhe falas në kuadër të projektit "Unë dëshmoj!" nga IDMC-Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (www.idmc.al).

Ky projekt synon të mbështesë mësuesit e historisë në mbarë Shqipërinë duke iu ofruar materiale shtesë nga persona që kanë vuajtur dënimin dhe persekutimin gjatë diktaturës. Përveçse do të vendosen pjesë të intervistave në faqen online të IDMC, personat e intervistuar do kenë mundësinë të ftohen në takimet që IDMC organizon me të rinjtë në qytetet ku ata ndodhen, si dhe në shkollat e interesuara.

Unë, gjithashtu i jap leje IDMC të përdorë dokumentet e mëposhtme:
Fotot e marra gjatë intervistës;
Fotografitë ose objektet që i kam dhënë hua organizatorëve të projektit;

Përtej dakordësisë sime në lidhje me përdorimin sa më sipër, përjashtim bëjnë:
.....
.....
.....
.....

Data:
Nënshkrimi (i/e intervistuari/a) Nënshkrimi (Ekipi i projektit)

FJALORTH I TERMAVE TË PËRDORURA NË MANUAL

Shënim: Më poshtë kemi përcaktuar disa terma, sipas përdorimit të tyre në këtë Manual. Këto terma janë përcaktime të autorëve të Manualit, përjashtuar rastet kur specifikohet ndryshe.

Arkivi (Archive) - (Shih edhe "depo/magazinë") Një "depo" e organizuar, ku të gjitha materialet janë ruajtur në mënyrë sistematike. Zakonisht, arkivat kanë një sistem, një rend alfabetik ose numerik, i cili u mundëson vizitorëve të gjejnë të dhënat që u duhen.

"Depo/magazinë" (Depository) - Vendi/et ku do të depozitohen materialet e projektit. "Depot" mund të jenë dixhitale, të tilla si një hard disk i jashtëm apo një disk i një kompjuteri, ose mund të jenë fizike, p.sh. një raft për vendosjen e dosjeve. Nëse ju keni vetëm një depo fizike, do ishte mirë të kishit edhe kopje dixhitale rezervë.

Dëshmitar okular (Eye witness) - Individ që ka përjetuar ose ka qenë dëshmitar i një ngjarjeje apo mënyre jetese specifike gjatë një periudhe të caktuar.

Dixhitalizimi (Digitalisation) - Procesi i krijimit të kopjeve dixhitale të materialeve të projektit. Kjo mund të përfshijë skanimin dhe ruajtjen e këtyre materialeve në hard disqe apo në internet. Por edhe krijimin e materialeve të projektit në kompjuter ose në pajisje të tjera elektronike si tableti ose telefoni celular, formate të tjera për shkrimin ose, për shembull, pajisjet për regjistrimin dixhital.

Drejtues projekti/koordinator (Project manager) - Individ që mbikëqyr projektin gjatë të gjitha fazave të tij dhe siguron përfundimin e projektit. Në projektet shkollore, drejtuesi i tyre mund të jetë mësuesi/ja. Ndërsa në projektet e kërkimit, drejtuesi mund të jetë kërkuesi i ri dhe/ose udhëheqësi i temës.

Histori e jetës (Life history) - Historia e jetës së një personi. Intervista e historisë së jetës së një personi fokusohet në dëshminë personale. Zakonisht, historitë e jetës fokusohen mbi jetën e të intervistuarve.

Histori gojore (Oral history) - Dëshmia verbale mbi të kaluarën nga ata që e kanë përjetuar, si dhe metoda e intervistës që përdoret për të mbledhur këto dëshmi.

Historiografi (Historiography) - Krijimi i narrativës historike.

Indeksi (Indexing) - Praktika e caktimit të përshkrimeve të shkurtra në dokumente me shumë informacione, si transkriptet, për të vlerësuar ose shqyrtuar më lehtë atë material gjatë fazave të mëvonshme ose pas përfundimit të projektit. Për shembull, termat: "Korça," "1997," "Migrimi" dhe "Diaspora" mund të përdoren për të përshkruar një intervistë me dikë që ka folur për kujtimet nga fëmijëria gjatë lëvizjes nga Korça në New York, SHBA, në vitin 1997, pas rënies së skemave piramidale në Shqipëri.

I intervistuari (Interviewee) - (Shihni edhe dëshmitar okular) Individ që është intervistuar. Në rast të intervistës së historisë gojore, i intervistuari është individ që ndan kujtimet dhe dëshminë e tij.

Intervistë e thelluar (In-depth Interview) - Metodë cilësore dhe stil intervistimi që zakonisht përfshin më shumë se një perspektivë të individit mbi një temë kërkimore. Intervistat e thelluara janë të strukturuar lirshëm. Me fjalë të tjera, përveç pyetjeve të përgatitura, intervistuesi duhet të jetë i përgatitur për të bërë pyetje që dalin gjatë bisedës, në bazë të përgjigjes së të intervistuarit (Mack, Woodsong, MacQueen, Guest dhe Namey, 2005: 29).

Intervistuesi (Interviewer) - Individu që kryen intervistën. Në rastin e historisë gojore, intervistuesi është individ që bën pyetjet dhe dëgjon dëshminë e të intervistuarit.

Kohëzgjatja e projektit (Project timeline) - Plan për të gjitha detyrat e nevojshme që duhet të përfundojnë deri në fund të projektit, nga faza e planifikimit fillestar deri në fazën e zbatimit dhe më tutje, në fazën e vlerësimit të projektit dhe reflektimit mbi të. Kohëzgjatja e projektit duhet të reflektojë objektivat e projektit, qëllimet dhe kufizimet kohore. P.sh., mësuesit e shkollës së mesme mund t'i kufizojnë projektet e tyre shkollore brenda semestrit ose vitit shkollor, ndërsa studiuesit e rinj duhet të konsiderojnë sasinë e fondeve që kanë, nëse kanë, si edhe kohëzgjatjen e programit të tyre të studimeve.

Konfidencialiteti (Confidentiality) - Sigurimi dhe mbrojtja e të dhënave personale të individit dhe/ose të informacioneve identifikuese, veçanërisht të atyre individëve që nuk dëshirojnë të identifikohen në studim.

Kujtim i regjistruar (Recorded memoir) - Tipikisht, koleksioni i kujtimeve të shkruara ose të regjistruara nga një individ mbi momentet ose ngjarjet që kanë ndodhur gjatë jetës së tij/saj. Zakonisht, memuarët regjistrohen nga vetë personat dhe nuk përfshijnë domosdoshmërisht një intervistues.

Marrëdhënie/Raport (Rapport) - Marrëdhënie e ngushtë dhe miqësore mes dy ose më shumë njerëzve. Në rastin e intervistave të historisë gojore, intervistuesi dhe i intervistuari duhet të krijojnë një lloj raporti, i cili duhet t'ju mundësojë të dyve që të diskutojnë hapur mbi projektin dhe historinë e jetës së të intervistuarit. Më me rëndësi është se e lejon të intervistuarin të ndihet i qetë gjatë kryerjes së intervistës dhe të shprehet lirshëm.

Marrëveshje mirëkuptimi (Memorandum of Understanding) - (E njohur gjithashtu, si "pëlqim i marrë pas informimit") Marrëveshje e bërë me të intervistuarin për të marrë pjesë në studim ose në projekt. Marrëveshja duhet të diskutohet tërësisht përpara intervistës me të intervistuarit e mundshëm dhe duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm: qëllimet / objektivat kryesore të projektit, kushtet e pjesëmarrjes, duke përfshirë kush mund të marrë pjesë, rreziqet e mundshme ose përfitimet nga pjesëmarrja në këtë studim dhe si do të përdoren të dhënat e mbledhura. Së fundmi, përpara se të jepet pëlqimi, individ duhet të sqarojë nëse intervista mund të regjistrohet.

Modeli i projektit (Project template) - Forma që duhet të ketë propozimi i projektit. Modeli juaj duhet të përfshijë një titull të qartë, emrat e drejtuesve të projektit dhe nëse ka, të stafit mbështetës, qëllimin dhe objektivat e projektit, një përshkrim të shkurtër që sqaron metodologjinë dhe temën e projektit, si dhe kohëzgjatjen dhe buxhetin e tij

Narrativë e jetës (Life narrative) - (Shih histori jete) Rrëfim ose histori që përshkruan jetën e individit.

Objektivat (Main objectives) - Rezultatet e synuara dhe shpesh konkrete, të projektit. Objektivat, ndryshe nga qëllimet dhe temat, janë të përqendruara, praktike dhe të realizueshme ose të matshme. Për shembull, në një projekt të historisë gojore, një objektiv mund të jetë promovimi i komunikimit mes brezave rreth një ngjarjeje të caktuar, si p.sh. midis gjimnazistëve dhe brezit të prindërve dhe të gjyshërve të tyre.

Personel mbështetës (Supporting staff) - Individët që ndihmojnë 'drejtuesin e projektit' të zbatojë projektin. Në një projekt kërkimor, personeli mbështetës mund të përfshijë asistentë kërkimi, të cilët, p.sh., ndihmojnë në kryerjen apo transkriptimin e intervistave. Në një

projekt në klasë, personeli mbështetës mund të jetë, p.sh. anëtar i një organizate lokale që ndihmon në identifikimin e të intervistuarve. Jo të gjitha projektet kanë staf mbështetës, veçanërisht ato që ndodhin në një shkallë më të vogël.

Pozicionimi (Positionality) - Praktika e reflektimit të pozicionit tuaj në një projekt, mënyra si ky pozicion e ndikon atë. Vlerat, pozicioni dhe pikëpamjet tuaja personale ndikojnë jo vetëm si e perceptoni botën, ose si do zgjidhni të analizoni transkriptet e intervistës, por gjithashtu edhe se si ju kanë perceptuar pjesëmarrësit në studimin tuaj (Sanchez 2010, 2258).

Privatësi (Privacy) - Aftësia e individit të ketë kontroll mbi veten dhe mbi çfarëdo informacioni ose të dhëne personale.

Pyetje specifike (Specific questions) - Një formë e tyre janë pyetjet e mbyllura, të cilat marrin kryesisht një përgjigje specifike. Për shembull: Kur ka ndodhur kjo ngjarje? A morët pjesë në këtë ngjarje? Kush e organizonte këtë ngjarje?

Pyetje të hapura (Open-ended questions) - Lloj pyetjesh që nuk kanë një përgjigje të veçantë ose specifike dhe i mundësojnë të intervistuarit të shprehet më gjatë. Për shembull: Pse morët pjesë në këtë ngjarje? A mund të përshkruani se si u ndjetë kur ishit atje?

Qëllim i projektit (Goal of project) - Qëllimi kryesor mbi të cilin bazohet projekti. Qëllimi ose moto shpesh shkojnë përtej objektivave praktike në mënyrë që të përfshijnë një fushë më të gjerë interesi kërkimor.

Regjistri i projektit (Project register) - Formë që përdoret për të shënuar përparimin e projektit të historisë gojore. Regjistri i projektit shënon fazën aktuale të çdo interviste të historisë gojore - nëse, kur, dhe nga

kush është kryer, transkriptuar dhe indeksuar. Për më tepër, regjistri përmban informacion shtesë ose sende që lidhen me secilën intervistë, siç janë fotografitë.

Teknologjia (Technology) - Pajisjet e përdorura gjatë gjithë zhvillimit të projektit. Në rastin e intervistave të historisë gojore, që mund të përfshijë regjistruar audio, kamera, hard disk dhe /ose kompjuter portativ ose celular.

Të drejtat e autorit (Copyright) - Të drejtat ligjore të një autori mbi punët e tij artistike ose letrare. Në rastin e historisë gojore, të intervistuarit kanë të drejtë mbi dëshmitë e tyre dhe se si ato ndahen apo përdoren në të ardhmen.

Transkriptimi (Transcript) - Shënime të nxjerra nga intervista. Praktikë e këshillueshme gjatë përgatitjes së transkriptimit është që në të të përfshihen ndërprerje, tinguj, madje edhe shenja vizuale, përveç fjalëve të intervistuesit dhe të intervistuarit. Transkriptimi duhet të përfaqësojë intervistën sa më saktë që të jetë e mundur dhe nuk duhet të redaktohet, përveç në rastet kur ka nevojë për qartësi në të shprehur. Nëse është kështu, atëherë individit që transkripton intervistën - transkriptuesi - duhet të shënojë se ku është redaktuar teksti për të qenë më i qartë.

Vendi i intervistimit (Interview place) - Vend i përcaktuar mbi të cilin është rënë dakord më parë dhe ku do zhvillohet intervista. Praktikë e mirë do të ishte që intervistuesi të pyetjet paraprakisht se ku do ta japë intervistën. Gjithashtu, është mirë të zgjidhet një vend që është paksa privat ose i qetë nëse planifikoni që ta regjistroni intervistën.

Vlerësimi i projektit (Project evaluation) - Ushtrim reflektues ose ushtrime të tjera të kryera në fund të projekti dhe nganjëherë edhe gjatë procesit të zbatimit, me qëllim të vlerësimit të çfarëdo rezultati

dhe rishikimi i të gjithë arritjeve dhe sfidave të fazës së planifikimit dhe zbatimit të projektit. Qëllimi i kryerjes së vlerësimit është të përcaktojë pikat e forta dhe të dobëta e projektit, ndonjëherë me qëllim të zbatimit të gjetjeve nga vlerësimi në projektet e ardhshme.

BIBLIOGRAFIA

Abu-Lughod, Lila. 2008. *Writing Women's Worlds: Bedouin Stories*. Berkeley: University of California Press.

American Historical Association. 2004. "Statement on Oral History and Institutional Review Boards." <https://www.historians.org/jobs-and-professional-development/statements-standards-and-guidelines-of-the-discipline/statement-on-oral-history-and-institutional-review-boards>.

Anderson, Kathryn & Dana C. Jack. 2003. "Learning to listen: interview techniques and analyses" in *The Oral History Reader*, edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library. 157 -170.

Bourdieu Pierre. 1997. "Das Elend der Welt." Zeugnisse und Diagnosen alltäglichen Leidens an der Gesellschaft, Konstanz (fq 773-802).

Boyd, Douglas A., Janice W. Fernheimer, and Rachel Dixon. 2015. "Indexing as Engaging Oral History Research: Using OHMS to "compose history" in the writing classroom." *The Oral History Review*, 42(2): 352-367.

Frisch, Michael. 2003. "Oral history and Hard Times: a review essay" in *The Oral History Reader*, edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library. 29-37

Grele, Ronald J. 2003. "Movement without aim: methodological and theoretical problems" in *The Oral History Reader*, edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library. 38-52

Haley, Alex. 2003. "Black History, oral history and genealogy" in *The Oral History Reader*, edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library. 9-20

Johnson, Melencia M. and Philip B. Mason. 2017. "Just Talking about Life": Using Oral Histories of the Civil Rights Movement to Encourage Classroom Dialogue on Race." *Teaching Sociology*, 45(3): 279-289.

Kati, Fabian. 2014. *Formësi i Kujtesës Kolektive: Kryengritjet e Malësisë së Madhe (1945-1946)*. Tiranë: Universiteti Europian i Tiranës.

Kuhn, Cliff and Marjorie L. McLellan. 2006. "Voices of Experience: Oral History in the Classroom." *Preparing the Next Generation of Oral Historians: An Anthology of Oral History Education*, edited by Barry A. Lanman and Laura M. Wendling. Lanham, Maryland: Altamira Press. E-reader edition.

Lanman, Barry A. 2006. "The Oral History Experience: A Model for use of oral history in education." *Preparing the Next Generation of Oral Historians: An Anthology of Oral History Education*, edited by Barry A. Lanman and Laura M. Wendling. Lanham, Maryland: Altamira Press. E-reader edition.

Lanman, Barry A. and Laura M. Wendling. 2006. *Foundation Preparing the Next Generation of Oral Historians: An Anthology of Oral History Education*. Edited by Barry A. Lanman and Laura M. Wendling. Lanham, Maryland: Altamira Press. E-reader edition.

Lleshanaku, Luljeta and Agron Tufa. 2014. *Zërat e Kujtesës, Vëllimi I*. Tiranë: ISKK.

- 2015. *Zërat e Kujtesës, Vëllimi II*. Tiranë: ISKK.
- 2016. *Zërat e Kujtesës, Vëllimi III*. Tiranë: ISKK.
- 2018. *Zërat e Kujtesës, Vëllimi IV*. Tiranë: ISKK.

Mack, Natasha; Cynthia Woodsong; Kathleen M. MacQueen; Greg Guest; and Emily Namey. 2005. *Qualitative Research Methods: A Data Collector's Field Guide*. Family Health International, <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/Qualitative%20Research%20Methods%20-%20A%20Data%20Collector%27s%20Field%20Guide.pdf>.

Mlynar, Jakub. 2016. "Analysing Oral Histories: Social Roles and Narrative Self-Regulation in Holocaust Survivors' Testimonies." SAGE Publications, Ltd. 2-7.

Mëhilli, Elidor. 2017. *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World*. Ithaca, New York: Cornell University Press.

Morrissey, Charles T. 2003. "On oral history interviewing" in *The Oral History Reader*, edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library, 101-113

Mulleti, Fatbardha Saraçi. 2014. *Dhimbje 3. : Tiranë: Shtëpia Botuese Ilar*.

Oral History Association and American Historical Association. 2003. "Policy Statement." <https://www.historians.org/jobs-and-professional-development/statements-standards-and-guidelines-of-the-discipline/statement-on-oral-history-and-institutional-review-boards>.

Oral History Association. 2012. "Is your oral history legal and ethical?" <http://www.ohs.org.uk/advice/ethical-and-legal/5/#interview-clarification>

Passerini, Luisa. 2003. "Work ideology and consensus under Italian fascism" in *The Oral History Reader* edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library, 53-62

Pollock, Della. 2005. "Introduction: Remembering" in *Remembering: Oral History Performance*, edited by Jacquelyn Dowd Hall, Della Pollock, and Fred Halliday. New York: Palgrave Macmillan, 1-19

Rouverol, Alicia. 2005 . "Trying To Be Good: Lessons in Oral History and Performance" in *Remembering: Oral History Performance*, edited by Jacquelyn Dowd Hall, Della Pollock, and Fred Halliday. New York: Palgrave Macmillan, 19-45

Popular Memory Group. 2003. "Popular memory: theory, politics, method" in *The Oral History Reader*, edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library, 75-86

Portelli, Alessandro. 2003. "What makes oral history different" in *The Oral History Reader* edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library, 63-74

Ritchie, Donald. 2001. "Institutional Review Boards and Oral History." *Oral History Association Newsletter* 35, 4.

Sangster, Joan. 2003. "Telling our stories: feminist debates and the use of oral history" in *The Oral History Reader* edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library, 87-100

Sommer, Barbara W & Mary Quinlan. 2009. *The Oral History Manual, second edition*. Lanham, Maryland: AltaMira Press.

Sánchez, L. 2010. "Positionality." In B. Warf (Ed.), *Encyclopedia of geography* (pp. 2258-2258). Thousand Oaks, CA: SAGE Publications, Inc. doi: 10.4135/9781412939591.n913

Stein, Alan H. and Marie Scatena. 2006. "Stud's Place in Oral History Education." *Preparing the Next Generation of Oral Historians: An Anthology of Oral History Education*. Edited by Barry A. Lanman and Laura M. Wendling. Lanham, Maryland: Altamira Press. E-reader edition.

Stone, Elizabeth. 2013. "Teaching Oral History in a College-Level "New Wave Immigrant Literature" Course." *The Oral History Review*. 40(2): 332-362.

Thiessen, Janis. 2014. "From Faith to Food: Using Oral History to Study Corporate Mythology in Canadian Manufacturing Firms." *Oral History*, 42(1): 59-72.

Thompson, Paul. 2003. "The voice of the past: oral history" in *The Oral History Reader*, edited by Robert Perks & Alistair Thomson. Taylor & Francis e- Library, 21-28

Tobbell, Dominique. 2016. "Teaching with Oral histories." *Bulletin of the History of Medicine*, 90(1): 128-135.

Webb, Sharon; Chris Kiefer; Ben Jackson; James Baker; and Alice Eldridge. 2017. "Mining Oral History Collections Using Music

Information Retrieval Methods." *Music Reference Services Quarterly*, 20(3-4): 168-183.

Yow, Valerie Raleigh. 2005. *Recording Oral History - A Guide for the Humanities and Social Sciences*, Second Edition. Walnut Creek, California: AltaMira Press.

Zieren, Gregory R. 2011. "Negotiating between Generations: A Decade of Experience Teaching Oral History." *The Oral History Review*, 38(1): 158-174.

2006. Foxfire and the Foxfire Approach: Excerpts from the Publications of the Foxfire fund, Inc. *Preparing the Next Generation of Oral Historians: An Anthology of Oral History Education*. Edited by Barry A. Lanman and Laura M. Wendling. Lanham, Maryland: Altamira Press.

2006. "Excerpts from Oral History and the Law: "Teaching Considerations" and "Institutional Review Boards and the Law." *Preparing the Next Generation of Oral Historians: An Anthology of Oral History Education*. Edited by Barry A. Lanman and Laura M. Wendling. Lanham, Maryland: Altamira Press.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë
Manual mbi historinë gojore: ide e praktika për nxënës,
mësues dhe *studiuues të rinj* / Instituti për Demokraci, Media
dhe Kulturë.

- Tiranë : IDMC, 2018
96 f. : me foto ; 14.8x21 cm.
Bibliogr.

ISBN 978-9928-4482-1-7

1.Historia gojore 2.Intervista 3.Manuale
303.686 (035)



ISBN 978-9928-4482-1-7

